

Dr. Musli Vërbani

**Papërcaktori dhe përcaktori
Përgjithësuesi dhe specifikimi i tij**

Kaçanik, 2019

KAPITULLI I PARË

- **Mutlak – Papërcaktori dhe**
- **Mukajjed – Përcaktori**

KAPITULLI I DYTË

- **Përgjithësuesi (el Amë), dhe**
- **specifikimi i përgjithësuesit**

Fjala specifike (El-Has)

Definicioni i fjalës “specifikuese”:

Fjalë specifikuese është fjala e përdorur për të treguar vetëm një kuptim në mënyrë të veçantë.

Fjala specifike

- ose mund të përdoret për një person të caktuar, si f.v. emrat e përveçëm,

Shembull: “Halid”, “Muhamed” etj,

- ose përdoret për të treguar vetëm një lloj.

Shembull: “Njeriu”, “Kali” etj,

- ose përdoret për një shumë të caktuar dhe të përkufizuar si f.v. “numërori”.

Shembull: dy, tre, dhjetë, njëzetë, tridhjetë, njëqind, populli,

- ose përdoret për një kuptim të vetëm.

Shembull: “dituria”, “injanca”.

Fjala e cila përdoret për llojin është konsideruar prej familjes së fjalës specifike nga shkak se shikohet nga kuptimi i drejtë i asaj për të cilën është vendosur, e ajo është një dhe nuk është e shumënumërt (shumëllojtësh).

Nuk e pengon këtë fjalë në kuptim të drejtë që në të të jenë personat apo llojet e përfshira brenda kuptimit të saj.

Nëse fjala tregon shumësin por jo në formën e fjalës së drejtë, por tregon nga ana e ndodhjes në vetë çështjen, si për shembull fjala *qiej*, fjalë që është prej familjes gjenerale.

Shembull: Thënia e Zotit të Lartmadhëruar: **“Dhe faleni namazin”**.

Fjala “fale” është në formën urdhërore.

Urdhërori është fjalë specifike.

Kjo tregon, në mënyrë të prerë, obligueshmërinë e namazit.

Shembull: Thënia e Zotit të Lartmadhëruar: **“jepni zekatin”**

Fjala “jepni” është në formën urdhërore.

Urdhërori është fjalë specifike.

Kjo tregon në mënyrë të prerë obligueshmërinë e zekatit.

Ligji i fjalës specifikuëse

Fjala specifikuëse përdoret në formën e prerë dhe bindëse, përderisa nuk vjen ndonjë argument tjetër i cili i jep kuptim tjetër.

Me fjalën “në formë të prerë” kemi për qëllim të themi se nuk mund të ketë kuptim tjetër, i cili buron nga argumenti, ndërsa nuk kemi për qëllim të themi se kurrë nuk mund të ketë kuptim tjetër.

Shembull:

Zoti i Lartmadhëruar thotë: “**Agjërimi i tij** (duhet të jetë) **tri ditë.**”

Fjala “**tri ditë**” në ajet ka kuptim të prerë dhe nuk lejohet as më pak as më shumë, sepse fjala është specifike dhe nuk mund t’i jepet kuptimi për më pak ose për më shumë, sepse tregueshmëria është e prerë

Shembull tjetër:

Fjala “**dhjetë**” në ajetin ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“**Dhe kompensimi i tij është të ushqyerit e dhjetë të varfërve.**”

Fjala “**dhjetë**” ka kuptim të prerë.

Fjala në kuptim të prerë nuk lejohet as më pak as më shumë sepse fjala është specifike dhe nuk mund t’i jepet kuptimi për më pak ose për më shumë sepse tregueshmëria është e prerë.

Shembull tjetër:

Ajeti kur'anor:

“Të shkurorëzuarat le të presin me vetveten e tyre tre kuruë.”

Fjala **“Kuruë”** (periodë kohore) është specifike dhe nuk mund t'i jepet kuptimi për më pak ose për më shumë sepse tregueshmëria është e prerë. Parashtrohet pyetja çfarë interpretimi duhet t'i jepet fjalës “kuruë”?

Fjala **“kuruë”** (periodë kohore) është fjalë dykuptimëshe:

- përdoret për ciklin e menstruacionit
- përdoret për kohën e pastërtisë (në mes dy menstruacioneve).

Qëllimi është për njërin kuptim të caktuar.

Ajeti fisnik ka nënvizuar se ideti (koha e pritjes) i gruas së shkurorëzuar, pas kontaktimit, është tre “kuruë”. Në thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

“Të shkurorëzuarat le të presin me vetveten e tyre tre kuruë.”

“Kurui” është periodë kohore. Kuptimi i periodës kohore ka kuptimin e menstruacionit, sepse fjala “tre” është fjalë specifike dhe në mënyrë të prerë tregon për obligueshmërinë për tri perioda kohore (kuruë) të plota.

Perioda kohore e plotë, që do të thotë se nuk lejohet as shtimi në më shumë se tre, as pakësimi në më pak se tre.

Po të kishte fjala *kuruë* për qëllim kuptimin “pastrim”, do të ishte nënvlerësuar obligueshmëria e fjalës specifike, e ajo është “tre”, sepse “pastrimi”, në të cilin veç ka ndodhur shkurorëzimi, nëse llogaritet “idetit” (pastrimi), atëherë afati i pritjes së saj do të ishte tri pastrime të plota dhe një pjesë e pastrimit të katërt.

Po nëse llogaritet, atëherë afati i pritjes te ajo do të ishte dy pastrime të plota dhe një pjesë e pastrimit të tretë. Nuk ka dallim në mes të pastrimit të parë dhe të tretë. Mjafton që në të tretën të jetë një pjesë e pastrimit, dhe atëherë, nëse në të tretën kalon një pjesë sado e shkurtër e kohës, duhet t’i lejohet gruas që të martohet. Ndërkaq, këtë nuk e pranon *Ixhmai i dijetarëve*.

Do të duhej që, nëse interpretohet fjala “**kuruë**” me kuptimin e “pastrimit”, shkurorëzimi, i cili duhet të jetë i ligjësuar, të jetë në momentin deri sa femra është në kohën e pastrimit, e kjo do ta kishte nënvlerësuar obligueshmërinë e fjalës specifike me shtesë ose pakësim, e kjo nuk është e lejuar.

Çka është e obliguar në mehr

Mehri është obligim që nga momenti i aktit të vlefshëm.

Baza ligjore është në parashtresën “b” në thënien e Zotit të Lartmadhëruar: **“Dhe u është e lejuar çka është pas kësaj për juve që të kërkonti për pasurinë tuaj”**.

Parashtresa “b” është fjalë specifike.

Gjuhësisht kuptimi i saj është bashkëngjitja.

Kjo tregon në mënyrë të prerë se kërkesa në aktin e vlefshëm është e pamundshme, sepse obligueshmëria e fjalës specifike është e prerë dhe assesi nuk lejohet të anashkalohet.

Nga kjo rezulton se autorizimi (kur gruaja, e cila e ka kujdestarin e saj, që ta martojë atë pa e emëruar mehrin), nëse asaj i vdes burri, para kontaktit dhe pa u pajtuar me shumën e mehrit është obligim *mehri i ngjashmërisë* (mehrul mithli), pasi që akti është bërë pa u përcaktuar shuma ose vlera e pasurisë, e nuk është i vlefshëm akti pa të.

Shembull: Thënia: “Kadiu vrau kriminelin”.

Në këtë rast është e mundur që kadiu ka gjykuar për vdekje, e kjo është mbështetur në argument, e argumenti është se detyra e kadiut është gjykimi, e jo ekzekutimi (vrasja e drejtpërdrejtë) i gjykimit.

Llojet e fjalës specifike, varësisht prej formës

Llojet më të rëndësishme të fjalës specifikuese janë:

- **E papërcaktuara,**
- **e përcaktuara,**
- **urdhërori dhe**
- **ndaluesi.**

Edhe pse ndonjëherë vjen e përkufizuar në numër të caktuar, do t'i sqarojmë dy llojet e para të fjalës specifike dhe atë: papërcaktorin dhe përcaktorin..

Prej fjalës specifikuese do t'i sqarojmë:

- **Të papërcaktuarën**
- **Të përcaktuarën.**

Kapitulli i parë

Mutlak - Papërcaktori

Mutlak - Papërcaktori

Nocioni i të papërcaktuarit

Papërcaktor: Është fjalë specifike.

Përcaktori tregon për personin apo personat në mënyrë të papërcaktuar e nuk e përcakton me një atribut prej attributeve. *Shembull:*

Njeri,
njerëz,
libër,
libra,
shpend,
shpendë,
nxënës.

Të gjitha këto fjalë tregojnë për personin e papërcaktuar të llojit të tij, apo persona të papërcaktuar, pa shikuar përgjithësimin apo gjithëpërfshirjen. Por, qëllimi është te esenca e fjalës apo vërtetësia, varësisht siç e pranon mendja, pa shikuar në përcaktimin e saj me ndonjë atribut prej attributeve. Kështu që papërcaktori është i barabartë me trajtën e pashquar, përderisa nuk ngërthen në vete përgjithësuesin (gjeneralen).

Ligji i papërcaktorit

Papërcaktori është i papërcaktuar përderisa nuk vjen ndonjë argument i cili e përcakton atë, dhe kjo kur papërcaktori vjen në një vend, nuk vjen përcaktori në ndonjë vend tjetër.

Fjala **“rob”** është fjalë specifike.

Fjala **“rob”** është fjalë specifike e papërcaktuar.

Fjala **“rob”** mund të jetë **“rob besimtar”** por fjala **“rob”** mund të jetë edhe **“rob pabesimtar”**.

Shembull:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar në kompensimin e përбетimit:

“ose lirimin e një robi”.

Kur të thuhet fjala **“rob”** tregon se lejohet të lirohet:
edhe robi **besimtar**,
edhe robi **pabesimtar**.

Lirimi i robit ka ardhur në **formën e urdhërorit**.

Shembull:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar për gratë me të cilat është e ndaluar martesë, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“dhe janë (të ndaluara) nënat e grave tuaja”.

Ky ajet tregon për ndalesën e nënës së gruas, që nga momenti i aktit të kurorëzimit me bijën e saj, pa marrë parasysh a kontakton me të apo jo.

Ajeti është i papërcaktuar dhe veprohet në mënyrë të papërcaktuar.

E papërcaktuara mbetet e papërcaktuar ndërsa e përcaktuara përcaktohet, siç është rasti në thënien e Zotit të Lartmadhëruar, kur i sqaron të ndaluarat:

“...Dhe vajzat që janë nën kujdesin tuaj e të lindura (prej tjetër babai) nga gratë tuaja me të cilat patët kontakt

Kushtëzimi i kontaktimit me gruan

Nuk ndalohet vajza e gruas (me burrë tjetër), por ndalohet vetëm nëse kontaktohet seksualisht me atë grua, pra me nënën e saj.

Nënat e grave ndalohen pa marrë parasysh a kontaktohet intimisht me to apo nuk kontaktohet intimisht me to.

Vajzat e grave ndalohen vetëm nëse pas martesës bëhet kontaktimi me to.

Përcaktimi i papërcaktorit

Papërcaktori mbetet i papërcaktuar përderisa nuk vërehet me diçka që e përcakton atë.

Shembull:

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Pas testamentit të cilin ka porositur ose pas borxhit”.

Testamenti mund të jetë i papërcaktuar.

Testamenti mund të jetë i përcaktuar.

Në bazë të ajetit fisnik testamenti është i papërcaktuar, që do të thotë se nuk parashihet ndonjë shumë e caktuar.

Ka ardhur argumenti i cili e përcakton atë në një të tretën. E, ai argument është thënia e Pejgamberi s.a.v.s. drejtuar Sead bin Vekasit:

“Një e treta, por edhe një e treta do të ishte shumë. Më mirë është që trashëgimtarët t’i lësh të pasur, se sa t’i lësh të varfër e duke lypur lëmoshë”.

Nëse vjen ndonjë argument i cili e përcakton papërcaktorin, atëherë papërcaktori përcaktohet.

Mukajjed - Përcaktori

Nocioni i përcaktorit

Përcaktori është fjalë specifike.

Përcaktori tregon për personin e shquar me një atribut prej attributeve ose është fjalë që tregon të përcaktuarën.

Shembull:

Fjala **njeri** është fjalë e papërcaktuar.

Fjala **njeri besimtar** është fjalë e përcaktuar.

Fjala **njerëz** është fjalë e papërcaktuar

Fjala **njerëz besimtarë** është fjalë e përcaktuar.

Fjala **grua** është fjalë e papërcaktuar

Fjala **grua e ndershme** është fjalë e përcaktuar.

Fjala **gra** është fjalë e papërcaktuar

Fjala **gra të ndershme** është fjalë e përcaktuar.

Në këto raste fjala specifike e ka zvogëluar (kufizuar) të papërcaktuarën.

Përcaktori është papërcaktori të cilin e pason përcaktori i cili e përkufizon nga e papërcaktuara në të përcaktuarën.

Ligji i përcaktorit

Veprohet me përcaktorin, ashtu siç është përcaktuar, përderisa nuk tregon ndonjë tregues për eliminimin e atij përcaktori dhe atëherë zëvendësohet me përcaktorin, i cili vjen pas tij.

Shembull:

Në kompensimin e **“Dhiharit”**:

“Dhe kush nuk gjen, (ai e ka obligim) agjërimin dy muaj rresht (pandërprerë), para se të kontaktojë”.

Fjala **“dy muaj”** është e papërcaktuar.

Fjala **“dy muaj rresht”** është fjalë e përcaktuar.

Agjërimi ka ardhur i përcaktuar me **“dy muaj rresht dhe pandërprerë”** dhe atë para se të bëhet kontaktimi seksual me gruan me të cilën ka bërë **“dhiharë”**.

Kështu duhet vepruar me këto dy përcaktime.

Nuk pranohet dhe nuk lejohet kompensimi i **Dhiharit** duke agjëruar me ndërprerje.

Nuk pranohet dhe nuk lejohet agjërimi pas kontaktimit me gruan, edhe nëse ai agjërim i pas kontaktimit, bëhet i pandërprerë.

Shembull tjetër:

E papërcaktuara mbetet e papërcaktuar ndërsa e përcaktuara përcaktohet siç është rasti në thënien e Zotit të Lartmadhëruar, kur i sqaron të ndaluarat:

“...Dhe vajzat që janë nën kujdesin tuaj e të lindura (prej tjetër babai) nga gratë tuaja me të cilat patët kontakt...”.

Kushtëzimi është *kontaktimi me gruan*.

Nuk ndalohet vajza e gruas (me burrë tjetër), përveç nëse kontaktohet seksualisht me atë grua, pra me nënën e saj.

Pjesa e ajetit për gratë me të cilat është e ndaluar martesë. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“dhe janë (të ndaluara) nënat e grave tuaja”.

Ky ajet tregon për ndalesën e nënës së gruas, që nga momenti i aktit të kurorëzimit me bijën e saj, pa marrë parasysh a kontakton me të apo jo.

Ajeti është i papërcaktuar dhe veprohet në mënyrë të papërcaktuar.

Nënat e grave ndalohen pa marrë parasysh a kontaktohet intimisht me to apo nuk kontaktohet intimisht me to.

Vajzat e grave ndalohen vetëm nëse pas martesës bëhet kontaktimi me to.

Përfundim:

Veprohet me të përcaktuarën si përcaktor përderisa nuk vërehet eliminimi i atij përcaktori.

Nuk lejohet të kalohet në të papërcaktuarën përderisa nuk vërtetohet me një argument, i cili tregon mosveprim me atë përcaktor.

Shembull tjetër:

Fjala “gjak” është fjalë e papërcaktuar.

Fjala “gjak rrjedhës” është fjalë e përcaktuar.

Ndalesa e gjakut rrjedhës në ajetin kur’anor:

“Edhe nëse është cofëtinë ose gjak rrjedhës”.

Gjak i ndaluar përcaktues është **“gjaku rrjedhës”.**

“Gjaku jorrrjedhës” i mushkërive nuk është i ndaluar.

Të barturit e të papërcaktuarës në të përcaktuar (Haml mutlak alel mukajid)

Të barturit (konvertimi) e të papërcaktuarës në të përcaktuar do të thotë:

- sqarimi i të papërcaktuarës me përcaktor ose
- përcaktimi i përcaktorit në përcaktor.

Agjërimi mund të bëhet tri ditë rresht pa shkëputje dhe agjërimi mund të bëhet ndaras me shkëputje.

Kur Ligjvënësi kërkon agjërimin e “**tri ditëve**” për atë që nuk ka mundësi ta kompensojë përbetimin e papërcaktuar rresht, pastaj vjen një argument tjetër dhe e përcakton këtë kompensim me agjërim rresht, atëherë bëhet bartja (konvertimi) e të papërcaktuarës në të përcaktuarën dhe e bëjmë obligim agjërimin rresht.

Dijetarët janë pajtuar se lejohet bartja e të papërcaktuarës në të përcaktuarën, mirëpo nuk janë pajtuar se në cilat raste është e lejuar që të bëhet kjo:

Nëse papërcaktori dhe përcaktori paraqiten në dy tekste, atëherë papërcaktori dhe përcaktori:

- ose janë në shkakun e ligjit,
- ose në vet ligjin.

Rasti i parë:

Nëse papërcaktori dhe përcaktori janë në **shkakun e ligjit**.

Në këtë rast nuk bartet (nuk konvertohet) papërcaktori në përcaktorin, por me secilin rregull (tekst) veprohet veç e veç.

Shembull:

Hadithi i ibni Umerit: **“I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka bërë obligim zekatul fitrin për Ramazan një saa prej hurmave ose një saa prej elbit për robin e të lirin, mashkullin dhe femrën, të voglin e të madhin prej muslimanëve”**.

Në një transmetim tjetër nuk është përmendur **“prej muslimanëve”**.

Ligji i të dy teksteve është i njëjtë: obligueshmëria e zekatul fitrit, mirëpo edhe papërcaktori edhe përcaktori janë në të njëjtin shkak të ligjit. E, ai shkak është personi i cili përkujdeset për atë që duhet dhënë zekatul fitrin, pasi që:

- në njërin transmetim është **i përcaktuar** që të jetë “prej muslimanëve”,
- në transmetimin tjetër është **i papërcaktuar**.

Në këto raste nuk bartet (nuk konvertohet) papërcaktori në përcaktorin, por veprohet me të dy rastet, dhe është obligim për muslimanin dhënia e zekatul fitrit për çdo person për të cilin përkujdeset, pa marrë parasysh a është musliman a jomusliman.

Veprohet me përcaktor në tekstin e parë dhe me papërcaktor në tekstin e dytë.

Përcaktori mund të jetë shkaktar, atëherë bëhet bartja (konvertimi) e papërcaktorit në përcaktor, e kjo bëhet atëherë kur ka kundërthënie në mes tyre.

Nëse papërcaktori dhe përcaktori janë të një shkaku të ligjit, nuk ka kundërthënie mes tyre, pasi që është e mundur të veprohet me secilin rast prej tyre në vendin e vet. Dihet se lejohet që për një çështje të ketë shkaqe të shumta, si p.sh.:

Bartja e pronësimit mund të bëhet nëpërmjet shitblerjes.

Bartja e pronësimit mund të bëhet nëpërmjet dhuratës.

Bartja e pronësimit mund të bëhet nëpërmjet testamentit.

Bartja e pronësimit mund të bëhet nëpërmjet trashëgimit, dhe bartja e pronësimit mund të bëhet nëpërmjet gjallërimit të tokës, etj.

Shembull tjetër:

Fjala e papërcaktuar për bagëtinë e deleve, dhe

fjala e përcaktuar për bagëtinë që kullotet në fushë.

Në një hadithë thuhet:

“Sa i përket zekatit të deleve që kulloten në fushë, nëse janë dyzetë dele (në kullosë), një dele jepet zekat.”

Në një hadithë tjetër thuhet:

“Në çdo dyzet dele, një dele jepet zekat.”

Shkaku është i njëjtë, obligueshmëria e zekatit të deleve, i cili numër është specifikuar për delet.

Papërcaktori bartet (konvertohet) në përcaktor.

Është obligim zekati i deleve që kulloten në fushë, e jo i atyre që u jepet ushqim vetëm në ahur.

Nuk është obligim zekati i deleve që u jepet ushqim vetëm në ahur.

Rasti i dytë:

Që të jenë edhe papërcaktori edhe përcaktori i të të njëjtit ligj.

Të këtij lloji janë katër forma, sepse:

- ose mund të unifikohet ligji,
- ose nuk mund të unifikohet ligji.

Në të dy rastet:

- ose mund të unifikohet shkaku,
- ose nuk mund të unifikohet shkaku.

- **Kur papërcaktori dhe përcaktori janë të bashkuar në ligj dhe në shkak.**
- **Kur papërcaktori dhe përcaktori ndryshojnë në ligj dhe shkak.**
- **Kur papërcaktori dhe përcaktori ndryshojnë në ligj, ndërsa shkaku është i njëjtë.**
- **Kur papërcaktori dhe përcaktori e kanë ligjin e njëjtë, por i kanë shkaqet të ndryshme.**

Forma e parë: Kur papërcaktori dhe përcaktori janë të bashkuar në ligj dhe në shkak

Shembull:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar për tejemumin:

“Dhe jepuni mes’h fytyrave tuaja dhe duarve tuaja”.

Në një ajet tjetër:

“Dhe nëse nuk mund të gjeni ujë, merrni tejemum me dhe të pastër dhe jepni mes’h fytyrave tuaja dhe duarve tuaja me të”.

Në të dy ajetet shkakun është i njëjtë: ***“Qëllimi i faljes së namazit”.***

Në të dy ajetet ligji është i njëjtë: ***“Obligueshmëria e mes’hit”.***

Papërcaktori bartet në përcaktor dhe bëhet vaxhib që gjatë tejemumit, mes’hi i fytyrës dhe i duarve të bëhet me dhe të pastër, e jo me dhe të papastër.

Ligji i saj është se papërcaktori bartet në përcaktor sepse përcaktori është përfundimtar, e papërcaktori më tutje nuk shikohet.

Nuk lejohet që papërcaktori dhe përcaktori të kenë kundërshtime në mes vete kur shkakun dhe ligjin e kanë të njëjtë, me fjalë tjera nuk mund të ketë kontraste në mes tyre në të njëjtën kohë.

- Kush vepron me përcaktorin, ai veç ka vepruar me papërcaktorin.

- Kush vepron me papërcaktorin, ai ka lënë anash argumentin e përcaktorit.

Për këtë arsye prioritare është obligueshmëria e bashkimit të tyre.

Shembull tjetër:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Ju është ndaluar juve cofëtina dhe gjaku.”

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Thuaj: “Në atë që më është shpallur mua (në Kur'an) nuk po gjej të ndaluar diçka nga ushqimi, përveç në qoftë se ai (ushqimi) është: cofëtinë, gjak i derdhur...”

Shkaku i të dy ajeteve është i njëjtë, e ai shkak është **dëmi i gjakut dhe e keqja e tij**.

Ligji është i njëjtë gjithashtu, e ajo është **“të ndaluarit e gjakut”**.

Nga këto dy raste e papërcaktuara bartet (konvertohet) në të përcaktuarën, kështu që gjaku, i cili është i ndaluar, është vetëm gjaku rrjedhës që shkëputet. Përderisa gjaku tjetër i mbetur në enë të gjakut nëpër mish, është i lejuar dhe ai konsumim i gjakut falet.

Forma e dytë: Kur ndryshojnë ligji dhe shkaku.

Shembull:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar për vjedhësin:

“Vjedhësit dhe vjedhëses preuani duart e tyre”.

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar në ajetin e abdesit:

“Dhe pastroni fytyrat e juaja dhe duart e juaja deri në bërryla”.

Në ajetin e parë fjala **“duart e tyre”** është e papërcaktuar.

Në ajetin tjetër fjala **“duart e juaja deri në bërryla”** është e përcaktuar.

Në të dy ajetet **shkaku** është i ndryshëm.

Në ajetin e parë **“vjedhja”**,

në ajetin dytë **“papastërtia dhe orientimi për namaz”**.

Në të dy ajetet **ligji** është për raste të ndryshme.

Në ajetin e parë është: **“Dënimi i prerjes së dorës së vjedhësit”**.

Në ajetin e dytë është: **“pastrimi i duarve”**.

Duke shikuar ndryshimin e tyre në shkak dhe ligj, e papërcaktuara nuk bartet (nuk konvertohet) në të përcaktuarën, pasi që nuk bëhet bashkimi i tyre.

Suneti e ka caktuar vendin e prerjes së dorës, e ai vend është e tërë shuplaka, sepse Pejgamberi s.a.v.s. ka urdhëruar **që të pritët shuplaka e vjedhësit**.

Në tejemum mes’hi i jepet duarve deri në bërryla, pasi që kështu bëhet bartja e (konvertimi) të papërcaktuarës në përcaktor.

Është thënë se në tejemum i jepet mes’h vetëm shuplakave të duarve, sepse kjo është pjesa të cilën e ka nënvizuar teksti, është bërë specifikimi i shuplakave deri në kyç, e jo deri në bërryla, duke u bërë analogji me prerjen e dorës së vjedhësit.

Shembull tjetër:

Obligueshmëria e agjërimit të dy muajve rresht në rastin e kompensimit të vrasjes gabimisht, në thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

“Dhe kush nuk ka mundësi (të paguajë me pasuri), le të agjërojë dy muaj rresht”.

Dhe obligueshmëria e agjërimit të tri ditëve, por pa qenë i kushtëzuar rreshtimi në thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

“Dhe kush nuk ka mundësi (të paguajë me mjete materiale), le të agjërojë tri ditë”.

Ligji është për raste të ndryshme.

Në ajetin e parë është **“agjërimi dy muaj”**, përderisa në ajetin e dytë është **“agjërimi tri ditë”**.

Shkaqet janë të ndryshme.

Në ajetin e parë është shkak **“vrasja gabimisht”**,

Në ajetin e dytë është shkak **“thyerja e betimit”**.

Në këto raste papërcaktuesi i të dytës nuk bartet në përcaktorin e të parës, e kjo sipas shumicës absolute të dijetarëve, përpos Hanefijve.

Hanefijtë e kanë bërë obligim agjërimin e kompensimit të thyerjes së betimit, duke u bazuar në Kiraetin e vetmuar (*Shadhë*) të Ibni Mes’udit: **“Dhe kush nuk ka mundësi (të paguajë me mjete materiale), le të agjërojë tri ditë (rresht)”**.

Forma e tretë: Kur ndryshojnë ligjet, ndërsa shkaku është i njëjtë.

Shembull:

Në ajetin e abdesit Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe lani fytyrat e juaja dhe duart e juaja deri në bërryla”.

Në ajetin e tejemumit Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe jepni mes’h me të (dhe) fytyrave tuaja dhe duarve tuaja”.

Në abdes duart janë të përcaktuara deri në bërryla.

Në tejemum duart nuk janë të përcaktuara.

Ligji është i ndryshëm në të dy ajetet:

Në ajetin e parë ligji ka të bëjë me pastrimin në abdes.

Në ajetin e dytë ligji ka të bëjë me mes’hin (fërkimin) në tejemum.

Shkaku është i njëjtë, e ai shkak është papastërtia dhe pastrimi prej papastërtisë për t’u falur.

E papërcaktuara nuk bartet në të përcaktuarën, por në secilin rast veprohet ashtu siç është, përpos nëse paraqitet ndonjë argument që imponon bartjen, sepse nuk ka diçka që e konteston bashkimin e tyre. E, atëherë muxhtehidët orientohen te suneti.

Obligim është mes’hi i duarve deri në bërryla, duke u bazuar në thënien e Pejgamberit s.a.v.s. në hadithin të cilin e transmeton Ibn Umeri (hadithi merfuë): **“Tejemumi është prej dy fërkimeve, fërkimi i fytyrës dhe fërkimi i duarve deri në bërryla”.**

Forma e katërt: Kur ligji është i njëjtë, por shkaqet janë të ndryshme.

Kur ligji është i njëjtë, por shkaqet janë të ndryshme, e papërcaktuara nuk bartet (nuk konvertohet) në të përcaktuarën, por veprohet me të papërcaktuarën në vendin e saj dhe me të përcaktuarën në vendin e saj.

Shembull:

Kompensimi i “*dhiharit*” dhe
kompensimi i *vrasjes së paqëllimtë*.

Në një ajet Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Të bëhet lirimi i një robi, para se të kontaktojë (seksualisht me gruan)”.

Në një ajet tjetër Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Të bëhet lirimi i një robi besimtar”.

Ligji në të dy ajetet është i njëjtë.

Në ajetin e parë fjala është e papërcaktuar **“lirimi i një robi”**.

Në ajetin e dytë fjala është përcaktuese **“lirimi i një robi besimtar”**.

Shkaqet në të dy ajetet ndryshojnë:

- në rastin e **“dhiharit”** qëllimi i vazhdimit të marrëdhënieve seksuale me bashkëshorten.

- në ajetin e dytë është për **rastin e vrasjes** dhe atë vrasje pa qëllim.

Në këto raste, e papërcaktuara nuk bartet në të përcaktuarën, por veprohet me të papërcaktuarën në vendin e saj dhe me të përcaktuarën në vendin e saj.

Kompensimi i **vrasjes së paqëllimtë** bëhet me lirimin e rob-it
besimtar,

kompensimi i **dhiharit** është “**lirimi i rob-it**”, pa marrë
parasysh a është besimtar apo pabesimtar.

Argument

Nuk ka nevojë të bëhet bartja e të papërcaktuarës në këto
raste, sepse nuk ka kundërthënie në mes tyre, sepse ndryshimi i
shkaqeve e pengon që të mos ndodhë kundërshtim në mes tyre,
ngaqë,

kompensimi i **vrasjes së paqëllimtë** duhet të jetë më i rreptë
për vrasësin dhe rreptësia është që ai të obligohet të lirojë vetëm
rob besimtar, pra kushtëzohet që rob-i të cilin e liron të jetë
besimtar.

A, te kompensimi i **dhiharit**, gjykimi është më i lehtë dhe më
konstruktiv, e kjo për të ruajtur bashkëshortësinë, kështu që burri
obligohet të lirojë çfarëdo rob-i qoftë, posaçërisht pasi që është
rregull sheriativ se:

- Ndryshimi i indikativit ndryshon varësisht prej ndryshimit
të indikacioneve.

- Ndryshimi i dënimeve ndryshon varësisht prej ndryshimit të
krimeve.

- Ndryshimi i veprave penale ndryshon varësisht prej peshës
së veprës penale.

KAPITULLI I DYTË

Përgjithësuesi (El-Amë)

Fjala përgjithësuese (El-Amë)

Definicioni i fjalës përgjithësuese

Në etimologji *përgjithësues* do të thotë:

Gjithëpërfshirje e çështjes së shumënumërt, pa marrë parasysh se ajo çështje a është në të shprehur apo në formë tjetër.

Në terminologji, *përgjithësues* do të thotë:

Shprehje e cila përfshin të gjitha njësitë që kanë të bëjnë me të.

Shembull:

Fjala **“burrat”** (njerëzit) përfshin të gjitha njësitë që i takojnë kësaj shprehje.

Format e përgjithësuesit

Përgjithësuesi vjen në katër forma:

- Fjalët në shumës,
- fjalët e llojit,
- fjalët e turbullta dhe
- emri njëjës i shquar.

Fjala në “shumës” si f.v.:

muslimanët, kodrat, të mirët, të këqijtë, etj.

Fjala e “llojit” si f.v.:

njerëzit, gratë, devetë, kafshët.

Këto nuk janë fjalë shumësi, sepse nuk janë të një lloji.

Fjalët “e turbullta”, Shembull:

“kush” është për krijesat e logjikshme, ndërsa

“çka” është për krijesat e palogjikshme, nëse është pyetëse, ose për vendosjen e kushtit, ose të dënimit.

Fjala “i cili” është për shumësin.

Fjala “ku” është për vendin, ndërsa

fjala “kur” është për kohën.

Emri në njëjës nëse është me nyjën shquese (“El-in” shques). *Shembull:*

“El-insanë - njeri”, “vel-katil - vrasësi”, “Ves sarikatu – hajdut”, e të ngjashme.

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Hajdutit dhe hajdutes preuani duart e tyre.”

Fjala **“hajdut”** është me nyjën shquese (“el”-in) dhe kjo fjalë është fjalë përgjithësuese dhe përfshin çdo hajdut.

Fjala **“hajdute”** është me nyjën shquese (“el”-in) dhe kjo fjalë është fjalë përgjithësuese dhe përfshin çdo hajdute.

Fjalët treguese të përgjithësuesit

Përgjithësuesi i ka shprehjet të cilat tregojnë për të, e ato janë:

a. Fjalët në shumës. Shembull:

“çdo”,

“O ju grup”,

“të gjithë”, “në përgjithësi”, e të ngjashme.

Shembull:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Çdo njeri, për atë çka ka fituar, është i zënë peng.”

Shembull:

“A mos po thonë, ne të gjithë jemi ngadhënjimtarë.”

Shembull tjetër, thënia e Pejgamberit s.a.v.s.:

“Ne grupi i pejgamberëve nuk trashëgohe mi”.

b. Shumësi i shquar me “El-in shques”, i cili tregon gjithëpërfshirjen ose shquarsinë shtesë.

Shembull: Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Veç kanë shpëtuar besimtarët!”,

Fjala besimtarët është fjalë me “el-in” shques dhe tregon përgjithësimin dhe gjithëpërfshirjen e të gjithë besimtarëve.

“Vërtet muslimanët dhe muslimanet.”,

Fjala muslimanët është fjalë me “el-in” shques dhe tregon përgjithësimin dhe gjithëpërfshirjen e të gjithë muslimanëve.

Fjalët me nyjën shquese (me “el-in” shques) tregojnë për përgjithësuesin, pa marrë parasysh a është shumësi i drejtë i gjinisë mashkullore apo shumësi i zhdrejtë.

Argumenti

Argumenti është *ixhmai i sehabeve*.

Sehabet janë dakorduar se shumësi tregon përgjithësimin.

Sehabet e kanë kuptuar përgjithësuesin nëpërmjet kësaj forme atëherë kur ensarët iu kanë përgjigjur muhaxhirëve në sekife të Beni Saidetit dhe kanë thënë: “Ne kemi *prijësin dhe ju keni prijësin*”, e muhaxhirët kanë thënë thënien e Pejgamberit s.a.v.s. “**prijësit janë prej kurejshitëve**”.

Ky argumentim vlen kështu përderisa shumësi nuk ka argument se “Elifi” dhe “Lami” nuk janë për specifikim, siç është rasti ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Ata të cilët u thonë njerëzve, vërtetë njerëzit janë tubuar kundër juve, pra frikësojuni atyre”.

Fjala “njerëz” ka për qëllim: Neim Bin Mesudin el Sihaijun.

Fjala “njerëz” në të dytën herë ka për qëllim “Ebu Sufjanin dhe grupin e tij.”

Shumësi i cili kuptohet me ndonjë shenjë plotësuese, siç është rasti i thënies së Zotit të Lartmadhëruar:

“Allahu ju obligon juve për fëmijët tuaj”.

Tregohet përgjithësuesi, ngase argument për këtë është përjashtimi i shumësit shtesë, siç është edhe fjala e Zotit të Lartmadhëruar:

“Vërtet, sa i përket robërve të mi, mbi ta nuk do të kesh fuqi përpos prej atyre kriminelëve që të pasojnë ty”.

Përjashtimi nga përgjithësimi është shumësi i pashquar.

c. Shumësi i pashquar.

Shumësi i pashquar: është shumësi i cili përdoret për shumë persona të papërkufizuar me një fjalë e pa përfshirje.

Në shumësin e pashquar kushtëzohen tri kushte:

Kushti i parë:

Që fjala të jetë njëkuptimëshe, për të mos u konsideruar kuptimi i dytë. *Shembull*: “Burrrat”.

Zoti i Lartmadhëruar thotë :

“E madhërojnë Atë në të ditë e natë burrrat”.

Fjala “burrrat” është shumësi i pashquar.

Fjalët “muslimanët”, “populli”, e të ngjashme janë shumësi i pashquar.

Kushti i dytë:

Të jetë shumësi i pashquar pa ndonjë element tregues i cili nuk tregon përgjithësisht, sepse është e mundur që të ketë kuptimin e çdo lloji të llojeve të atij numri si njëjësi dhe ndonjësi i pashquar.

Nëse thuhet: U ngritën “burrrat” asnjëri nuk mund të kuptojë se qëllimi është se është ngritur çdonjëri prej burrave.

Kushti i tretë:

Të jetë shumësi i pashquar i cili nuk përfshin të gjithë individët, por përfshin disa prej tyre.

Dallimi në mes të papërcaktuarës, të përcaktuarës, trajtës së shquar, trajtës së pashquar dhe përgjithësuesit

E papërcaktuara

E papërcaktuar është fjala e cila tregon kuptim të drejtë.

Shembull :

“Burri është më i mirë se gruaja”.

Me këtë kemi për qëllim vërtetësinë e burrit dhe të gruas, sepse çdo gjë e ka specifikën e vet me të cilën dallohet. Si f.v. gjallesa logjike është vet njeriu.

Kjo e vërtetë ndryshon nga të tjerat, si p.sh., njeriu mund të jetë një, por mund të jenë shumë njerëz. Fjala burrë është fjalë papërcaktuese, sepse ne kemi për qëllim natyrshmërinë e tij, edhe pse thuhet në mënyrë gjenerale. Sepse ngjashëm me këtë është fjala “njeriu” por që nuk është i përcaktuar, pra i pashquar.

Trajta e shquar

Trajta e shquar është fjala që tregon diçka të njohur e të caktuar, pa marrë parasysh a është një person, një lloj apo një gjini.

Kjo bëhet me njëren prej shtatë mënyrave si në:

- emër të përveçëm,
- përemër,
- përemër dëftor,
- emër në trajtën e shquar (me “el”) në rasën gjinore.

Shembull: Zejdi dhe shtëpia e ministrit.

Trajta e pashquar

Trajta e pashquar është fjala që tregon diçka, por të panjohur.

Shembull: Njeri.

Fjala “njeri” është e pashquar sepse tregon për një person mashkull prej bijve të Ademit, të moshës madhore, të papërcaktuar.

E pashquara nuk është e përgjithshme (gjenerale), por ajo tregon diçka të veçantë (specifike).

Numërorët

Numërorët tregojnë për njësi të shumënumërta por të përkufizuara, që, përpos të numëruarve, nuk përfshin të tjera.

Shembull: pesëdhjetë.

E përgjithshmja

E përgjithshme është ajo që tregon për persona të panumërt, dhe që përfshin çdo pjesë të asaj fjale në kuptim të drejtë, me fjalë tjera përfshin çdo person prej personave. *Shembull:* Të gjithë ata që janë idhujtarë.

Minimumi i shumësit

Minimumi i shumësit është aq sa është numri i tyre.

Argument:

Argument se minimumi i shumësit është aq sa është numri i tyre, se çdo herë kur përmendet shumësi, logjika e kupton kështu.

Njëjësi shques me “el” gjithëpërfshirës dhe njëjësi i shquar në rasën gjinore.

Njëjësi me trajtën shquese (me “el”) tregon minimumin e shumësit po aq sa është numri i tyre.

Argument:

Argument për këtë është se çdo herë kur përmendet shumësi, logjika e kupton kështu.

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Hajdutit dhe hajdutes preuani duart e tyre”,

Fjala **“hajdut”** është në njëjës me trajtën shquese (me “el-in”) dhe kjo fjalë është fjalë përgjithësuese dhe përfshin çdo hajdut.

Fjala **“hajdute”** është në njëjës me trajtën shquese (me “el-in”) dhe kjo fjalë është fjalë përgjithësuese dhe përfshin çdo hajdute.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“E ka lejuar shitblerjen dhe e ka ndaluar kamatën”.

Fjala “shitblerje” përfshin (tregon) çdo lloj shitblerje sepse është për gjithëpërfshirje.

Fjala “kamatë” përfshin çdo kamatë sepse është për gjithëpërfshirje.

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Vërtetë njeriu është në një humbje të sigurt, përpos atyre të cilët kanë besuar.”

Fjala “njeriu” është fjalë përgjithësuese dhe në këtë rast përfshin çdo njeri përpos ata që i ka përjashtuar ajeti.

Njëjësi i shquar në rasën gjinore

Njëjësi i shquar në rasën gjinore tregon përgjithësimin dhe përmbledhjen e njësive.

Shembull:

Për të ngordhurat në det, Muhamedi a.s. ka thënë:

“Uji i tij është i pastër, është e lejuar ngordhësira e tij”.

Nyjëtimi **“i tij”** tregon rasën gjinore.

Hadithi në fjalë, nëpërmjet rasës gjinore tregon përgjithësimin se, të gjitha të ngordhurat në det janë të lejuara.

Trajta e pashquar në kontekstin e mohimit, ndalimit apo kushtit

1. Trajta e pashquar në kontekstin e mohimit.

E pashquara në kontekstin e mohimit tregon përgjithësimin dhe përmbledhjen e njësive.

Shembull i të pashquarës mohuese:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar: **“Nuk ka dhunë në fe”**.

Thënia e Pejgamberit s.a.v.s.: **“Nuk ka testament për trashëgimtarin.”**

Hadithi përfshin çdo testament, pasi që në këtë formë ka ardhur ndalesa, përpos nëse e lejojnë trashëgimtarët, siç tregohet në disa transmetime.

Nëse trajta është trajtë e pashquar në formën e pohimit, nuk ka përgjithësim, pos nëse ka ndonjë argument shtesë.

2. Trajta e pashquar në kontekstin e ndalimit.

Trajta e pashquar në kontekstin e ndalimit tregon përgjithësimin dhe përmbledhjen e njësive.

Shembull i të pashquarës së ndalimit:

“Dhe mos ia fal (namazin e xhenazes) asnjërit prej tyre kurrë”.

Ajeti i përgjithëson të gjithë hipokritët, pasi që ka ardhur fjala (asnjërit prej tyre) në formën e ndalesës.

3. Trajta e pashquar në kontekstin kushtit.

Trajta e pashquar në kontekstin kushtit tregon përgjithësimin dhe përmbledhjen e njësive.

Shembulli i të pashquarës së kushtit:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Nëse ju vjen ndonjë mëkatar (fasik) me ndonjë lajm, sqarojeni dhe vërtetoni”.

Fjala **“fasik-mëkatar”** tregon përgjithësimin, pasi që ka ardhur në formën kushtëzuese.

1. Përemrat: *Shembull:* “Çka”, “kush”, “cili”, “ata”, “të cilët”.

Siç është rasti te thënia e Zotit të Lartmadhëruar:
“Dhe është e lejuar për juve çka të jetë përpos kësaj”.
Përemri “çka” tregon për përgjithësim.

“Dhe çka ka prej gjallesave në tokë, furnizimi i tyre është vetëm prej Allahut.”,

“Allahut i bien në sexhde çdokush në qiej dhe çka ka në tokë.”

“Vërtet ata të cilët hanë pasurinë e jetimëve me padrejtësi, vërtet ata kanë ngrënë për barkun e tyre zjarr.”,

“Dhe ato të cilat nuk kanë shpresë për menstruacion nga gratë e juaja”.

2. Kushtori:

Shembull: “kush”, “çka”, “cili”, “kudo”.

Siç është rasti ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:
“Dhe kush nga ju prezanton në këtë muaj, le të agjërojë.”,

“Dhe çka do që të shpenzoni prej të mirave, do t’ju kompensohet juve.”,

“Me cilin emër e thirrni Atë, Atij i takojnë emrat e bukur.”,

“Kudo që të jeni do t’ju kapë vdekja.”

3. Pyetësja:

Shembull: “Kush”, “Çka”, “Kur”, “Ku”.

Shembuj të përgjithësuesit me pyetësor:
Ajetet në Kur'an ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Kush veproi kështu me zotat tanë o Ibrahim?”,

“Çka ka dashur Allahu me këtë shembull?”,

“Kur do të jetë ndihma e Allahut”,

“Kudo që të jeni e luteni përpos Allahut, a?”

Tregueshmëria e përgjithësuesit

Forma e përgjithësuesit përdoret për gjithëpërfshirje dhe përmbledhje të të gjitha njësive.

Përgjithësuesi i mbetur prej përgjithësimit tregon për të gjitha njësitë dhe ligjësimi është se përgjithësuesi vepron te të gjitha njësitë që i përkasin asaj, përderisa nuk tregon për specifikimin e tij.

Përgjithësuesi i posaçëm tregon atë se çka ka mbetur prej individëve pas specifikimit, në bazë të hamendjes, e jo në formë të prerë, sepse, në shumicën e rasteve, në argumentimin e specifikimit duhet që të jetë e arsyetuar, e ky arsyetim mund të jetë real në individë tjerë prej asaj çka ka mbetur pas specifikimit, e për shkak të ekzistimit të kësaj mundësie, atëherë çka të jetë prej përgjithësuesit nuk tregon në formë të prerë, por në formë jo të prerë.

Argumentet nga Kurani, nga Ixhmai i sehaveve dhe argumenti logjik

1. Argument nga Kur'ani:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Dhe nuk e ka çmuar (besuar) Allahun ashtu siç e meriton të çmohet (besohet), kur kanë thënë: Nuk i ka zbritur njeriut asgjë. Thuaj: Kush e ka zbritur librin, i cili i ka ardhur Musait, dritë dhe udhëzim për njerëzit”.

Fjala “njeriu” dhe “asgjë” tregojnë përgjithësim dhe gjithëpërfshirje, nga shkak se është dhënë kundërpërgjigjja ndaj tyre, se libri i ka zbritur Musaut.

2. Ixhmai i sehaveve dhe i gjuhëtarëve

Është arritur Ixhmai i sehaveve dhe i gjuhëtarëve se në fjalorin e Kur'anit dhe sunetit është përdorur përgjithësimi, përderisa nuk është sjellë ndonjë argument për specifikimin e tij.

Sehabet janë argumentuar me përgjithësuesin e shumësit shtesë me rastin për trashëgiminë e Fatimes r.a. prej Pejgamberit s.a.v.s.

Fatimja r.a. ka dashur ta trashëgoj parcelën e tokës së njohur të ashtuquajtur “Fedele vel Avalij”,

Fatimja r.a. është argumentuar me ajetin Kur'anor:

“Ju obligon Allahu (trashëgiminë) për fëmijët tuaj”.

Ebu Bekri Sidiki i është kundërpërgjigjur Fatimes r.a. se nuk ka të drejtë të trashëgoj dhe është argumentuar me hadithin e Muhamedit a.s.:

“Ne pejgamberët nuk trashëgohe mi, çka lëmë prej pasurisë, jepet sadaka”.

3. Argumenti logjik

Vetë përgjithësuesi bën që mendja ta pranojë formën e përgjithësuesit. E kjo është argument se praktikisht përdoret për përgjithësim.

Nëse zotëriu i thotë shërbëtorit: Çdokujt që hyn në shtëpinë time jepja një dërhem.

Shërbëtori nuk e zbaton urdhrin përderisa nuk i jep çdokujt që hyn në shtëpi.

Llojet e përgjithësuesit

Fjala përgjithësuese është tri llojesh:

1. Përgjithësuesi i cili kategorikisht nuk lejon specifikimin,
2. përgjithësuesi i cili kategorikisht kërkon specifikim, dhe
3. përgjithësuesi asnjans (përgjithësuesi i cili as nuk e kërkon kategorikisht të specifikohet dhe as nuk e ndalon të specifikohet).

1. Përgjithësuesi i cili ka për qëllim përgjithësimin në formë të prerë.

Përgjithësuesi i cili ka për qëllim përgjithësimin në formë të prerë përfshin të gjitha elementet, kjo nënkupton se ky përgjithësues nuk lejon të specifikohet.

Shembull:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Dhe nuk ka gjallesë në tokë e që nuk e ka prej Allahut furnizimin e saj”.

Ajeti ka zbritur në mënyrë të përgjithshme dhe nuk lejon specifikim.

2. Përgjithësuesi që ka për qëllim specifikimin në formë të prerë.

Ky lloj përgjithësuesi ka elemente që mohojnë, që ai të mbetet gjithmonë në përgjithësimin e tij.

Shembull:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Allahu ka obliguar njerëzit, ata që kanë mundësi t’i përballojnë rrugës, ta vizitojnë dhe ta kryejnë haxhin në shtëpinë (e Tij)”.

Ky është përgjithësimi i specifikuar për të ngarkuarit, sepse logjika e pranon se në fjalën “njerëz” bëjnë pjesë fëmijët dhe të çmendurit.

Nga fjala “njerëz” e këtij ajeti përjashtohen fëmijët dhe të çmendurit.

Fëmijët dhe njerëzit e çmendur nuk e kanë për obligim haxhin.

3. Përgjithësuesi asnjanes.

Përgjithësuesi asnjanes është përgjithësuesi që nuk ka element as për përgjithësimin e tij dhe nuk ka element as për specifikimin e tij.

Tregueshmëria e këtij përgjithësuesi është në formë të prerë përderisa nuk specifikohet.

Kur themi se tregueshmëria e këtij përgjithësuesi është në formë të prerë përderisa nuk specifikohet atëherë për atë pjesë tregueshmëria është jo e sigurt.

Argument:

Përdorimi i përgjithësuesit është për përgjithësim, kështu që përderisa nuk paraqitet ndonjë argument për specifikimin e përgjithësuesit, përgjithësimi është domosdoshmëri.

Mundësia e specifikimit është mundësi ose ajo që nuk e ka burimin nga vetë argumenti, por që përgjithësimi nuk është i patjetërsueshëm, sikurse nuk mund të ndikojë asnjë alegori me “fjalën specifike” që të jetë i prerë.

Sehabet e kanë kuptuar përgjithësuesin nëpërmjet teksteve kur'anore. Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Prostitutën dhe lapërdharin shkopojeni, çdonjërin prej tyre, me nga njëqind të rëna.”

Ajeti në mënyrë të prerë përfshin çdo prostitut/e.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Ata të cilët prej juve vdesin, dhe lënë gra, gratë e tyre le të presin katër muaj e dhjetë ditë.”

Ajeti në mënyrë të prerë përfshin çdo grua së cilës i vdes burri.

Specifikimi i përgjithësuesit

Specifikimi i përgjithësuesit

Lejohet specifikimi i përgjithësuesit me argument, që do të thotë: ndryshimi nga e përgjithshmja, nëse dëshirohet të shkëputen disa njësi.

Përgjithësuesi specifikohet mirëpo kushtëzohet që argumenti i cili specifikon përgjithësuesin të jetë i një rangu me përgjithësuesin dhe i pavarur nga fjala, (apo që të jetë i një rangu me përgjithësuesin dhe i pavarur).

Specifikimi i përgjithësuesit është përkufizimi i fjalës në disa njësi ose ndryshimi i përgjithësuesit nga përgjithshmëria e tij dhe marrja e disa njësive prej tij.

Kjo në Kur'an ndodh shumë herë. Si për *Shembull*:

Përkufizimi i obligueshmërisë së haxhit në fjalën **“njerëz”**:

Fjala njerëz përfshin:

- njerëzit e mençur (jo të çmendur),
- njerëz të rriturit (dhe jo të vegjlit).

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Allahu ka obliguar njerëzit, ata që kanë mundësi ta përballojnë rrugën, ta vizitojnë dhe ta kryejnë haxhin në shtëpinë (e Tij)”.

Njerëzit e çmendur dhe fëmijët nuk e kanë për obligim kryerjen e haxhit.

Shembull tjetër:

Në bazë të ajeteve të trashëgimisë, fëmijët janë trashëgimtarë të prindërve të tyre, mirëpo është bërë specifikimi dhe prej peygamberëve nuk trashëgojnë fëmijët e tyre.

Në bazë të ajeteve të trashëgimisë trashëgimtarët tjerë përpos fëmijëve kanë të drejtë trashëgimie, mirëpo është bërë specifikimi dhe prej peygamberëve nuk trashëgojnë trashëgimtarët tjerë.

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Ne, Peygamberët nuk trashëgohejmë, çdo gjë që e lëmë pas është sadaka.”

*Ka dallim në mes të specifikimit dhe shfuqizimit,
dallimi qëndron në atë se:*

- shfuqizimi është anulim i ligjit të mëparshëm dhe vendosje e një ligji tjetër me argument shariativ të mëvonshëm.
- specifikimi është të sqaruarit se nga përgjithësuesi shkëputen vetëm disa njësi.

Specifikimi i Kur'anit me Kur'an

Teksti kur'anor mund të jetë specifikues.

Lejohet specifikimi me Kur'an pa marrë parasysh se ai specifikim a është i ngjitur me tekstin e përgjithshëm (ndërfjalor) apo është specifikim me tekst të mëvonshëm (jashtafjalor) kështu që specifikimin me Kur'an mund ta ndajmë në dy tema:

1. Specifikimi i përgjithësuesit Kur'anor me tekst të ngjitur të Kur'anit.

2. Specifikimi i përgjithësuesit Kur'anor me tekst të mëvonshëm të Kur'anit.

1. Specifikimi i përgjithësuesit Kur'anor me tekst të ngjitur të Kur'anit.

Shembull:

“Dhe ka lejuar Allahu shitblerjen dhe e ka ndaluar kamatën”.

Ajeti në mënyrë të përgjithshme e ka lejuar çdo lloj shitblerje. Pastaj në vazhdim të ajetit është bërë specifikimi me ndalimin e kamatës.

Pjesa e parë e ajetit:

“Dhe ka lejuar Allahu shitblerjen” është përgjithësues. Pastaj e ka bërë specifikimin me vazhdimin e ajetit në ndalimin e kamatës: **“dhe e ka ndaluar kamatën”**.

2. Specifikimi i përgjithësuesit kur'anor me tekst të mëvonshëm të Kur'anit.

Shembull:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar në suretul Bekare, ku thotë:

“Të shkurorëzuarat le të presin me veten e tyre tri kohëra të pastrimit”.

Ajeti është i përgjithshëm që do të thotë se përfshin në vete shtatzënat dhe jo shtatzënat.

Zoti i Lartmadhëruar ka bërë specifikimin e shtatzënave, ku thotë:

“Sa i përket shtatzënave, afati i pritjes së tyre është derisa të lindin”.

Shembull tjetër:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar në suretul Bekare, ku thotë:

“Të shkurorëzuarat le të presin me veten e tyre tri kohëra të pastrimit”.

Ajeti është i përgjithshëm, që do të thotë se përfshin të shkurorëzuarat para kontaktit intim dhe pas kontaktit intim.

Kur'ani ka specifikuar të shkurorëzuarat para kontaktit intim me thënien e mëvonshme ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Nuk ka për ju idet (kohë të pritjes) të cilën duhet të pritni”.

Të shkurorëzuarat me të cilat nuk ka kontakt intim nuk ka nevojë të presin tri kohëra të pastrimit.

Specifikimi i përgjithësuesit me Sunet

Lejohet specifikimi i përgjithësuesit me sunet pa marrë parasysh se ai specifikim a është i ngjitur me tekstin e përgjithshëm apo është i mëvonshëm nga teksti i përgjithshëm.

Shembull i specifikimit të mëvonshëm nga suneti mutevatir i Pejgamberit s.a.v.s. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

“Ju është bërë obligim kur ndonjërit prej jush i vjen vdekja, nëse lë pas vete pasuri, të lërë vasijet për prindërit dhe të afërmit me mirësi”.

Ky ajet është i përgjithshëm dhe e lejon testamentin për trashëgimtarët dhe jotrashëgimtarët.

Suneti pejgamberik e ka specifikuar Kur'anin kur Muhamedi a.s. ka thënë:

“Nuk ka testament për trashëgimtarin”.

Në bazë të hadithit të lartpërmendur nuk lejohet testament për trashëgimtarët sepse është specifikuar me hadithë.

Specifikimi i përgjithësuesit me veprat e të dërguarit s.a.v.s.

Nëse ndodh ndonjë vepër që është në kundërshtim me fjalën, të cilën e ka thënë në mënyrë të përgjithshme, që ka të bëjë me të gjithë të ngarkuarit tjerë, kjo tregon obligueshmërinë e specifikimit të asaj veprë, pra kalon prej përgjithësuesit në specifikues.

Shembull:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar: **“Allahu ju urdhëron për fëmijët tuaj (që të trashëgojnë), që për mashkullin të jetë pjesa sa e dy femrave; nëse janë më shumë se dy femra, atyre u takojnë dy të tretat (nga trashëgimia)”.**

Kjo është specifikuar me veprimin e Pejgamberit s.a.v.s., sepse ka lejuar që dy vajzat e Sead bin Rebias të trashëgojnë dy të tretat.

Veprimi i Muhamedit a.s. tregon se ajeti ka pasur për qëllim më shumë se dy femra.

Shembull tjetër:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Dhe mos ju afroni atyre deri sa të pastrohen”.

Pjesa e ajetit **“mos ju afroni”** specifikon vetëm marrëdhëniet intime.

Argument:

Argument për këtë është veprimi i Muhamedit a.s.

Pejgamberi s.a.v.s. u është afruar bashkëshorteve gjatë menstruacioneve por nuk ka kontaktuar intimisht.

Të afruarit me bashkëshorten, por jo në organin seksual, është i lejuar.

Aishja dhe Mejmunja kanë thënë:

“Kur isha me menstruacione e Pejgamberi s.a.v.s. dëshironte të na afrohej, na urdhëronte që të jemi të veshura (prej kërthizës e deri në gjunjë) dhe na afrohej”.

Specifikimi i përgjithësuesit të formës së prerë me argument të pasigurt

Përgjithësuesi i formës së prerë nuk mund të specifikohet me argument të pasigurt.

Përgjithësuesi i formës së prerë nuk mund të specifikohet me argument të pasigurt nga shkaku se specifikimi është tjetërsim, ndërsa e tjetërsuara e prerë nuk mund të konvertohet në jo të prerë.

Specifikimi i ajetit të Kur'anit me hadithin njëtransmetuesor

Nuk lejohet që, përgjithësuesi me argument të prerë të specifikohet me argument jo të prerë.

Përgjithësuesi prej Kur'anit fisnik, i cili është argument i prerë, nuk lejohet që të specifikohet me lajmin e vetëm (hadithin njëtransmetuesor), i cili është argument jo i prerë.

Shembull:

Ajeti kur'anor i cili është i prerë dhe i sigurt.

“Dhe mos e hani atë që nuk është përmendur emri i Allahut, mbi (prerjen) e saj”.

Është i ndaluar mishi i kafshës e cila prehet dhe me qëllim nuk përmendet emri i Zotit.

Ajeti fisnik është argument i sigurt, ndërsa hadithi në vijim është hadithë njëtransmetuesor, i cili nuk është argument i sigurt.

Hadithi i Muhamedit a.s.:

“Prerja e kafshës prej muslimanit është e lejuar, e kujtoi apo nuk e kujtoi emrin e Allahut (gjatë prerjes).”

Ajeti është argument i sigurt ndërsa hadithi njëtransmetuesor nuk është argument i sigurt, kështu që ajeti nuk mund të specifikohet me këtë hadithë sepse hadithi njëtransmetuesor nuk është i sigurt, me fjalë tjera nuk lejohet që përgjithësuesi të specifikohet me argument jo të prerë, në këtë rast me lajmin e vetëm (hadithin njëtransmetuesor).

Shembull tjetër:

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Strehoni ato, ashtu siç ju jeni strehuar në bazë të mundësive tuaja”.

Nuk lejohet që Kur’ani i cili është argument i prerë, të specifikohet me argument jo të prerë, si f.v. me lajmin e vetëm (hadithin njëtransmetuesor).

Vaxhib është strehimi dhe ushqimi për të shkurorëzuarën me *bejnunetul Kubra* (shkurorëzim i tretë, pa të drejtë kthimi), në bazë të thënies së Zotit të Lartmadhëruar:

“...strehoni ato, ashtu siç ju jeni strehuar në bazë të mundësive tuaja”.

Nuk merret parasysh hadithi prej Fatime Binti Kajsit, së cilës i është thënë se Pejgamberi s.a.v.s. nuk ka lejuar vendstrehim dhe shpenzime për raste të tilla.

Bazë ligjore për këtë është thënia e Umerit r.a.: *“Ne nuk e anashkalojmë librin e Zotit tonë e as të Pejgamberit tonë, për shkak të fjalës së një gruaje, nga e cila nuk e dimë a ka mbajtur përmendësh (hadithin) apo ka harruar në i takon asaj vendstrehimi dhe shpenzimi.”*

Specifikimi i suneteve mutevatir me hadithin njëtransmetuesor

Nëse përgjithësuesi është me argument të prerë në sunete mutevatir, nuk lejohet që të specifikohet me lajmin e vetëm (hadithin njëtransmetuesor), i cili është argument jo i prerë.

Nuk lejohet që përgjithësuesi i prerë të specifikohet me argument të pasigurt nga shkaku se tregueshmëria e përgjithësuesit në të gjitha njësitë e veta është i prerë.

Specifikimi është tjetërsim, ndërsa e tjetërsuara e prerë nuk mund të jetë jo e prerë.

Specifikimi i suneteve mutevatir me Kijasë

Nuk lejohet që suneti mutevatir i cili është argument i prerë, të specifikohet me analogjinë i cili është argument jo i prerë.

Specifikimi është tjetërsim, ndërsa e tjetërsuara e prerë nuk mund të jetë jo e prerë.

Është bërë specifikimi i ajetit: **“Hajdutit dhe hajdutes preuani duart”** me hadithin:

“Hajdutit dhe hajdutes preuani duart prej të katërtës së dinarit e më shumë”.

Kontradikta ndërmjet përgjithësuesit dhe specifikuesit

Mund të ndodhë të bie ndesh tregueshmëria e përgjithësuesit dhe tregueshmëria e specifikuesit.

Kontradikta ndërmjet përgjithësuesit dhe specifikuesit gjykohet varësisht se në çfarë mase është specifikuesi, ashtu që prershmëria e tyre të jenë të një niveli. Pastaj veprohet me mënyrën për të mënjeluar mospajtueshmërinë.

Specifikuesi e specifikon përgjithësuesin nëse specifikuesi nuk është i mëvonshëm.

- Nëse dihet cili është i mëhershëm dhe cili është i mëvonshëm, i jepet përparësi të mëvonshmit.

- Nëse nuk dihet cili është i mëvonshëm vendimi merret në bazë të përparësisë së tyre.

Shembull:

“Nisabi” i zekatit të pemëve dhe i të korrave:

Transmetohet në hadithë se Muhamedi a.s. ka thënë :

“Atë çka e ujit qielli (shiu) dhe burimet ose puset, për atë jepet një e dhjeta (5%). E ajo çka ujitet me mjete të ujitjes, sa gjysma e një të dhjetës (5%)”.

Në hadithë tjetër Muhamedi a.s. ka thënë:

“Nuk ka sadaka çka është në më pak se pesë Esvak.” (684 kg ose 715 kg të hurmave)”

Këtu kanë rënë ndesh hadithi i parë me hadithin e dytë.

Hadithi i parë është përgjithësues.

Hadithi i dytë është specifikuesi në atë më pak se pesë Evsak.

Ebu Hanife mendon se nuk kushtëzohet nisabi me atë çka nxirret (kultivohet) prej toke.

Dy nxënësit e tij Ebu Jusufi dhe Muhamedi e kushtëzojnë që të jetë nisabi pesë Evsak (684 kg ose 715 kg).

Shkak i mospajtueshmërisë së tyre janë dy hadithet e sipërpërmendura.

Sipas Ebu Hanifes: Nuk dihet kronologjia e haditheve, për këtë arsye veprohet me prioritaren, pra me përgjithësuesin.

Përgjithësuesi ka përparësi sepse përgjithësuesi obligon zekatin edhe për pakicë, kështu që veprohet me të si rezervë dhe e ka obliguar zekatin për çdo gjë që nxirret nga toka në mënyrë absolute edhe pa e arritur *nisabin*.

Dy nxënësit e tij Ebu Jusufi dhe Muhamedi e kanë specifikuar hadithin e dytë me të parin, dhe për pemët dhe për të korrurat nuk e kanë obliguar nëse është më pak se pesë Evsak.

Ebu Hanife nuk i ka dhënë përparësi specifikuesit ndaj përgjithësuesit kështu që nuk e ka kushtëzuar nisabin.

Dy nxënësit e tij Ebu Jusufi dhe Muhamedi i kanë dhënë përparësi specifikuesit ndaj përgjithësuesit, kështu që e kanë kushtëzuar nisabin.

Specifikimi i pashkëputur (ndërfjalor)

Specifikimi i pashkëputur: është ajo që nuk është pjesë e tekstit të përgjithshëm me të cilin ka ardhur teksti.

Format më të rëndësishme të kësaj kategorie janë:

- prekshmëria e logjikës,
- tradita,
- ixhmai,
- thëniet e sehaveve dhe
- teksti i Kur'anit dhe sunetit.

Prekshmëria apo dukshmëria.

Kur Ligjvënësi dëshiron të tregoj me tekst të përgjithshëm, tregon në atë mënyrë që nënkupton gjërat të cilat duken e preken. Ndjenja e kupton për specifikimin e tij në disa pjesë prej pjesëve të përgjithësuesit dhe kjo quhet specifikimi i përgjithësuesit në bazë të ndjeshmërisë dhe prekshmërisë. *Shembull:*

Fjala e Zotit të Lartmadhëruar me çështjen e cilësisë së erës shkatërruese:

“Shkatërrojnë çdo gjë me emrin e Zotit të Tij”.

Ne veç e dimë në praktikë se era nuk e shkatërrojnë tokën e qiellin, por edhe shumë çështje tjera, si yjet. Kështu që shqisat e ndjeshmërisë e specifikojnë këtë përgjithësues.

Në praktikë shohim se ky ajet është specifik për ato specifika sepse nga ana tjetër është treguar dhe përcaktuar se era shkatërrojnë posaçërisht atë për çka është dërguar për të shkatërruar. E, kjo është fjala e Zotit të Lartmadhëruar:

“Dhe te populli Ad kur dërguam kundër tyre erën shkatërruese, nuk ka lënë asgjë për çka është dërguar (të shkatërrojë), pos që e ka bërë hi e pluhur”.

Shembull tjetër:

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe iu është dhënë nga çdo gjë”.

Ajeti tregon për mbretërinë e vendit të Sebeit të Belkisës.

Kjo është specifikuar me gjendjen faktike sepse dihet se: çka ka qenë nën mbretërinë e Sulejmanit, nuk ka qenë në mbretërinë e Belkisës.

Logjika

Tekstet e përgjithshme, të cilat janë sjellë për obligueshmërinë në shariat, pa qenë i specifikuar: sepse të gjitha obligimet i specifikojnë të ngarkuarit, përpos fëmijëve dhe të çmendurve.

Shembull:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Prej Allahut është bërë obligim për njerëzit që ta bëjnë haxhin në shtëpinë e Tij.”

Ky ligjërime me përgjithësimin e tij përfshin edhe ata që nuk kuptojnë, si f.v. fëmija dhe i çmenduri,

Nga përgjithësuesi specifikohet fëmija dhe i çmenduri sepse këta përjashtohen nga përgjithësuesi me argumentin logjik.

Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“O ju njerëz, adhuronit Zotin tuaj”.**

Ky ligjërime me përgjithësimin e tij përfshin edhe ata që nuk kuptojnë, si f.v. fëmija dhe i çmenduri.

Nga përgjithësuesi specifikohet fëmija dhe i çmenduri. Këta përjashtohen nga përgjithësuesi me argumentin logjik.

Tradita dhe zakoni

Atë që e tregon teksti i përgjithshëm, lejohet që të specifikohet ajo që e parasheh shprehja faktike dhe fjala e drejtë.

Shembull i shprehjes së drejtë tradicionale:

Kur të përmendet fjala “Dërhëm”, në të shumtën e rasteve llogaritet valuta e vendit ku thuhet kjo fjalë.

Shembull i traditës praktike (faktike):

Nëse thuhet: **“Është i ndaluar ushqimi”**.

Nëse traditë e atij qyteti, ushqim kryesor ka qenë p.sh. “buka”, atëherë fjala është e përkufizuar në ndalimin vetëm të “bukës”, sepse ushqimi kryesor i atij qyteti zakonisht ka qenë buka.

Shembull tjetër: Përdorimi i fjalës kokë vetëm për kokën e dashit.

Kush përbetohet se nuk do të hajë kokë në qytetin ku zakonisht përdoret posaçërisht për ngrënien e bagëtive, ai nuk e ka thyer betimin nëse ha kokën e ndonjë kafshe tjetër e jo të dashit.

Specifikimi i përgjithësuesit me Ixhmaë

Lejohet specifikimi me ixhmaë.

Lejohet specifikimi me ixhmaë sepse ixhmai e vërteton tekstin e prerë të shariatit.

Dhe kur të bashkohen i prerë i qartë dhe i paqartë, atëherë i jepet përparësi të prerës.

“E vërteta është se, specifikimi bëhet me argumentin e ixhmait e jo me vetë ixhmain”.

Shembull: Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“O ju të cilët keni besuar, kur të thirret (ezani) për namaz në ditën e xhumasë, shpejtoni në përkujtim (falje të namazit) ndaj Allahut”.

Ixhmai është pajtuar se xhumaja nuk është obligim për robin, e as për femrën.

Pra, me Ixhmaë është bërë specifikimi i ajetit kur'anor kështu që robi dhe femra nuk e kanë për obligim namazin e xhumasë.

Specifikimi i përgjithësuesit me thënien e sehabes

Lejohet specifikimi me thënien e sehabes.

Argument

Thënia e sehabes është argument specifikues sepse sehabiju e ka dëgjuar prej Pejgamberit s.a.v.s., dhe vepron ashtu, kështu që lejohet ta specifikojë përgjithësuesin.

Argument

Argument për këtë është se Ibn Umeri ka thënë:

“Ne e kemi bërë fekondimin e pemëve në mënyrë artificiale dyzetë vjet dhe nuk kemi parë asgjë të keqe, përderisa erdhi Rafië Hudejxh dhe na lajmëroi se Pejgamberi s.a.v.s. na e ka ndaluar një veprim të tillë. Kështu që u larguam vetëm pse na tha Rafiju.”

Specifikimit i mëvonshëm me hadithë

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Ju është ndaluar juve cofëtina”.

Fjala cofëtinë është fjalë përgjithësuese dhe kjo fjalë në ajet është e përgjithshme dhe përfshin çdo cofëtinë.

Pjesa e ajetit “cofëtinë” është specifikuar me lejimin e “cofëtinës së detit” me thënien e Pejgamberit s.a.v.s. kur për çështje të detit ka thënë:

“Është i pastër uji i tij (i detit), lejohet cofëtina prej tij”.

Mënyrat e specifikimeve

Lejohen specifikimi i përgjithësuesit si në vijim:

- Lejohet të specifikohet përgjithshmëria e Kur'anit me Kur'an.
- Lejohet të specifikohet përgjithshmëria kur'anore me sunetin mutevatir.
- Lejohet të specifikohet përgjithshmëria e sunetit mutevatir me sunetin mutevatir.

Sa i përket specifikimit të Kur'anit me lajmin e vetëm:

- Nëse në përgjithësues unanimisht ka depërtuar specifikimi, lejohet specifikimi me lajmin e vetmuar.
- Nëse në përgjithësues nuk ka depërtuar specifikimi, nuk lejohet specifikimi me lajmin e vetmuar.
- Nuk lejohet specifikimi i Kur'anit me lajmin e vetmuar, përderisa nuk specifikohet me argument të qartë.

Heshtja e Pejgamberit s.a.v.s. për të kundërtën e përgjithësuesit

Nëse supozojmë se Pejgamberi s.a.v.s. e ka lejuar në heshtje ndonjë njeri të pijë diçka që është e ndaluar, kjo do të ishte specifikim i përgjithësuesit.

Kjo është kështu kur ai veç ka pasur mundësi ta thoshte të kundërtën, atëherë konsiderohet specifikues, sepse heshtja e veprimit e merr dispozitën e thënies (lejes) haptazi.

Kjo do të thotë se nuk mund të aprovohet në heshtje e kundërta e fjalës së thanësit.

Analogjia e tekstit specifikues ka përparësi nga përgjithësuesi i një teksti tjetër.

Analogjia specifikuese e specifikon tekstin e përgjithshëm.

Shembull:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Dhe Allahu e ka lejuar shitblerjen”.

Ky tekst është i përgjithshëm dhe e lejon çdo lloj shitblerje (këmbimi).

Pastaj ka ardhur teksti pejgamberik për ndalimin e kamatës në elb.

Shkaku është “masa”. Kështu që analogohet orizi me elbin dhe ndalohet kamata. Kështu bëhet “analogjia” e këtij teksti specifikues i së përgjithshmes e cila e lejon shitblerjen.

Shembull tjetër:

Specifikimi i hadithit:

“Nuk ka dyshim se veprat shpërblehen sipas qëllimit”.

Nëse burri i thotë gruas “ju jeni e shkurorëzuar” ndërsa qëllimin e ka pasur për shkurorëzim të tri hershëm, llogaritet vetëm një shkurorëzim, edhe pse qëllimi ka qenë për tre shkurorëzime.

Po ashtu, nëse ka për qëllim të shkurorëzoj gruan, por nuk e shpreh me gojë, nuk llogaritet shkurorëzim.

Specifikuesi i pandërprerë

Specifikuesi i pandërprerë është kur specifikues është pjesë e tekstit.

I kemi katër forma të specifikuesit të pandërprerë:

- Specifikuesi i ngjitur.
- Specifikuesi i kushtit.
- Specifikuesi i atributit.
- Specifikuesi i qëllimit.

Specifikuesi i ngjitur

Zoti i Lartmadhëruar thotë :

“Kush e mohon Zotin pas besimit të tij, përpos atij që është detyruar, ndërsa zemra është e mbushur me besim”.

Ky përjashtim pason pas përgjithësimin të ajetit, i cili përfshin çdo mohues.

Pabesimi i çdonjërit, i cili e shpreh pabesimin e tij haptazi, ndërsa zemrën e ka të mbushur plot me iman tregon se kufri (pabesimi) është ai i cili bëhet me dëshirë, e jo me imponim.

Specifikuesi i kushtit

Shembull thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Dhe juve ju takon gjysma e asaj që lënë gratë e juaja, nëse ata nuk kanë lënë fëmijë”.

Kusht për të trashëguar burri gjysmën e pasurisë së gruas është që të mos ketë fëmijë.

Nëse gruaja vdes dhe nuk ka lënë fëmijë zvogëlohet pjesa e burrit në gjysmën e pasurisë.

Po të mos ishte ky kusht, burrit nuk do t'i takonte gjysma e pasurisë.

Specifikuesi i atributit

Shembull thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Dhe kush prej jush nuk ka mundësi materiale që të martohet me femra të lira besimtare, le të martohet me ato besimtare tuaja që i keni nën pushtetin tuaj (robëreshat). All-llahu di më së miri për besimin tuaj. Ju jeni nga njëri-tjetri (të një origjine). Pra, martohuni me ato (robëresha) e me lejen e pronarëve të tyre dhe jepuni kurorën në mënyrë të drejtë, (zgjidhni) të ndershme e jo prostitute të haptë apo të fshehta. E kur të jenë të martuara ato, nëse bëjnë ndonjë punë të turpshme, ndëshkimi kundër tyre është sa gjysma e atij të grave të lira (jo robëresha). Kjo (martesë me robëresha) është e lejuar për ata që i frikësohen imoralitetit, por të jeni të durueshëm, është më mirë për ju. All-llahu është mirëdashës, mëshirëplotë.” (En-Nisa, 25)

Teksti tregon për lejimin e martesës me robëresha besimtare, në rast se nuk ka mundësi që pronari t’ua paguajë mehrin grave jo të robëruara.

Specifikuesi i qëllimit

Shembull thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“O ju që keni besuar, kur të ngriheni për t’u falur, pastroni fytyrat e juaja dhe duart e juaja deri në bërryla.”

Ajeti në fjalë tregon se maksimumi i kufirit të pastrimit është deri te “bërrylat”, e jo më shumë.

Përfundim

Specifikimi ka kuptim më të ngushtë, përfshin specifikimin vetëm jashtëtekstual që do të thotë se kushtëzohet që argumentimi i specifikimit të jetë i pavarur dhe i mëvonshëm,

Specifikimi ndërtekstual, si f.v. specifikimi i kushtit dhe specifikimi i përjashtimit quhen përkufizim i përgjithësuesit e jo specifikim.

Ajo çka është e përngjitur në të njëjtin tekst të përgjithësuesit quhet shfuqizim sepse specifikimi është kur kihet për qëllim të ndahet një pjesë prej të përgjithshmes me argument të ndarë (të pavarur) dhe të përngjitur me të.

Ligji i përgjithësuesit pasi që të specifikohet

Përgjithësuesi pasi të specifikohet, prapë mbetet në kuptim të drejtë të fjalës.

Argument

Fjala e cila ka kuptim të drejtë, edhe pas shkëputjes së një pjese (specifikimit të asaj fjale), pjesa e mbetur mbetet në gjendjen e mëparshme (në kuptim të drejtë). Nuk e dëmton asgjë nëse një pjesë prej saj është shkëputur sepse në të kuptuar fjalës paraprake nuk i humbet kuptimi nëse diçka i shkëputet asaj pa pasur diçka tjetër çka i jep kuptim tjetër.

Të vepruarit me përgjithësuesin para se të hulumtohet specifikimi i tij

Nuk lejohet të veprohet me përgjithësuesin para se të hulumtohet për specifikimin e tij. Kjo nga shkakut që të dominojë mendimi se nuk ka specifikim dhe që të mos bëhet gabim i mundshëm.

Kur të vërtetohet se nuk ka specifikim merret si bazë ligji i përgjithësimit dhe veprohet në bazë të tij.

Specifikimi i përgjithësuesit nëse është i bashkangjitur me lidhëzën pas fjalës specifikuese.

Nëse përdoret përgjithësuesi dhe disa njësi lidhen me lidhëz, gjë që bën që përgjithësuesi të përfshijë në vete, a i specifikon a jo?

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Ruani pesë kohët e namazit dhe namazin e mesëm”.

Kohët e namazit dhe lidhëza me kohën e namazit të mesëm.

Lidhja e përgjithësuesit me specifikuesin nuk e specifikon përgjithësuesin.

Lidhëza me përgjithësuesin nuk obligon përgjithshmërinë e të lidhurës.

Shembull tjetër:

Fjala e Zotit të Lartmadhëruar:

“Të shkurorëzuarat le të presin tri kohëra (cikle) të pastrimit”.

Pastaj Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe burrat e tyre kanë më së shumti të drejtë në kthimin (kurorëzimin) e tyre”.

Fjala e fundit është fjalë specifike enkas për “të kthyerat” sepse atributi “përparësi për kthim” është për ta, kështu që nuk është obligim që ata të cilat kthehen të presin tri kohëra të pastrimit, por gjithëpërfshin edhe të shkurorëzuarat e dyhershme, si dhe të shkurorëzuarat e tri hershme.

“Lidhori i përgjithësuesit obligon përgjithshmërinë e të lidhurës, në mes të të lidhurave në atributin e dispozitës”.

Lidhori i të specifikuarës obligon specifikimin e të lidhurës, ashtu siç është shprehja e dijetarëve:

“Sa herë që përgjithësohet e lidhura, është përgjithësuar edhe lidhori, sepse lidhori për ndërlidhshmëri bëhet vetëm se me argument. Specifikimi i të lidhurës obligon specifikimin e lidhorit me të cilën është specifikuar.”

Të veçuarit e njësisë nga përgjithësuesi me ligjin e tij, jo me ligjin specifikues

Veçohet njësia nga përgjithësuesi me ligjin përgjithësues.

Shembull:

Në një rast Muhamedi a.s. ka thënë:

“Çdo lëkurë e terur është e pastruar”.

Me rastin e deles së Mejmunes, Muhamedi a.s. ka thënë:

“Terja e lëkurës së saj (deles) është pastrimi i saj”.

Nuk ka kundërshtim mes këtyre dy haditheve.

Përcaktimi i deles me hadithin e Mejmunes nuk nënkupton specifikimin e përgjithshmërisë së hadithit: “Çdo lëkurë e terur është e pastruar”, sepse kjo do të thotë përcaktim i njësive të disa njësive të përgjithësuesit me shprehje, e cila nuk tregon diçka të re, vetëm me të kuptuarit e cilësisë së emrit, ndërsa të kuptuarit e cilësisë së emrit nuk është argument.

Nëse thuhet se Halidi është fisnik kjo nuk do të thotë se të tjerët pos Halidit janë përtacë.

Specifikimi i përgjithësuesit me të kuptuar të kundërt

“Të kuptuarit e kundërt” është ajo çka është e kundërta e fjalës.

Të kuptuarit e kundërt është specifikuese.

E kuptuara e kundërt se është përgjithësuese e ka bazën në atë se nëse i thuhet një njeriu: Në bagëtinë, e cila kullotet në fushë është farz zekati, kjo jep të kuptojë se në bagëtinë në ahur nuk ka zekat.

Shembull:

Thënia e Pejgamberi s.a.v.s.:

“Për bagëtinë në fushë jepet zekati”.

E kuptuara tregon se zekati jepet për bagëtinë në fushë.

E kuptuara e kundërt tregon se nuk ka zekat për bagëtinë në ahur (jo në fushë).

Këtë specifikim të së përgjithshmes e bënë hadithi tjetër: “Në çdo dyzetë dele, një dele jepet zekat”.

Ky hadithë tregon për obligueshmërinë e dhënies së zekatit për çdo dyzetë dele, pa marrë parasysh a janë në ahur apo në fushë.

Të përgjithësuarit mbështetës apo të përgjithësuarit nga anulimi retorik

Mbështetës është fjala e cila plotëson fshehjen (anulimin retorik), që do të thotë se fjala nuk është e drejtë po të mos e ketë atë fshehje.

Kemi fshehje (përemra paramendues) të shumënumërt. A paramendohen të gjithë përemrat, apo mjafton njëri prej tyre? Pra të paramenduarit është mbështetësi.

Mbështetësi (anulimi retorik) është shprehje shtesë e tekstuales. Me fjalë tjera, mbështetje është ajo çka fshihet detyrimisht nga fjalia e drejtë e folësit.

Mbështetësi (anulimi retorik) është dy llojesh:

1. Çka e kërkon të shprehurit e drejtë.
2. Çka e kërkon dispozita vendimmarrëse për të qenë ligji i domosdoshëm.

1. Çka e kërkon të shprehurit e drejtë.

Hadithi i Muhamedit a.s. **“Është hequr nga Umeti im gabimi dhe harresa”**.

Fjala **“heqje”**, pa kurrfarë dyshimi nuk është qëllimi i heqjes në tërësi, sepse edhe gabimi edhe harresa janë faktike, kështu që patjetër duhet t’i mbështetet diçka për të qenë fjalia e drejtë, e ajo mund të jetë:

- ose ndëshkimi,
- ose llogaritja, e të ngjashme.

“Është hequr (ndëshkimi) nga Umeti im gabimi dhe harresa”.

“Është hequr (llogaritja) nga Umeti im gabimi dhe harresa”.

Shihet se **“mbështetje”** është ajo çka fshihet detyrimisht nga fjalia e kuptimit të drejtë të folësit.

2. Çka e kërkon ligji vendimmarrës për të qenë ligji i domosdoshëm.

Shembull:

Liroje robin tënd për mua për dhjetë mijë.

Kjo është nënrenditje e fjalisë, sepse patjetër duhet të pronësohet robi, e që pastaj të lirohet.

Fjala në kuptim të drejtë dhe përcaktimi i përgjithësuesit

Nuk ka kurrfarë dyshimi se nëse argumenti i cili tregon për përcaktimin e njërës prej çështjeve të arsyeshme për përcaktim tregon atë përcaktim si p.sh.:

Kur Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Ju është ndaluar juve cofëtina”.

Ajeti ka të bëjë me “ndalimin e ushqimit (cofëtinës)”, pra, do të thotë: Ju është ndaluar ushqimi i cofëtinës.

Kur Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Ju janë të ndaluara juve nënat e juaja”.

Ajeti ndalon marrëdhëniet intime (me nënat), sepse fjala përcaktohet, e papërcaktuara është e barabartë me të shprehurën.

Fjala e cila ka shumë përcaktime nga përgjithësuesi i anulimit retorik

a. Shembull: Hadithi i Muhamedit a.s.:

“Është hequr nga umeti im gabimi dhe harresa”.

Fjalës “heqje”, patjetër duhet t’i mbështetet diçka për të qenë fjalia e drejtë, e ajo mund të jetë:

- ose ndëshkimi,

- ose llogaritja, e të ngjashme.

“Është hequr (ndëshkimi) nga umeti im gabimi dhe harresa”.

“Është hequr (llogaritja) nga umeti im gabimi dhe harresa”.

Përgjithësohet argumenti mbështetës me atë çka përcaktohet, me fjalë tjera përgjithësohet në ato njësi, sepse e mbështetura është e barabartë me citatin e marrjes së vendimit për atë çështje. Kështu që cilësia e të përgjithësuarës është njësoj sikurse citati.

Argumente:

“Përcaktimi në njërën prej përcaktimeve nuk ka përparësi nga tjetra, sepse po të bëhej kështu do t’i jepet përparësi pa të drejtë (me kushte të njëjta). Patjetër përcaktimi është për të gjitha”.

b. Përcaktimi i të gjithave ka vlerë më përfshirëse dhe më afër reales. Po t’i kishim përcaktuar të gjitha dispozitat në hadithin: “Është hequr nga umeti im”, do të kishte qenë më afër heqja e vetë substancës, e kjo do të ishte heqja e të gjitha dispozitave.

Mbështetja nuk është gjithëpërfshirëse, por gjithëpërfshirja bëhet vetëm me fjalët direkte, e jo nëpërmjet kuptimeve të shumta të fjalëve, dhe se caktohet njëra prej përcaktimeve, sepse gjithëpërfshirja është prej indikacioneve të fjalëve, ndërsa mbështetja është vetëm “kuptim”, çka do të thotë se nuk është gjithëpërfshirëse.

Argument

Përcaktimi bëhet me atë çka kërkon domosdoshmëria në masë të nevojës, ndërsa domosdoshmëria përcaktohet sa zgjat ajo domosdoshmëri dhe nuk ka nevojë të definohet gjithëpërfshirja, përderisa qëllimi është arritur; nevoja plotësohet dhe fjalës i është dhënë kuptimi i saj.

Thënia e Pejgamberit s.a.v.s.:

“Kush nuk e fillon agjërimin para sabahut, nuk ka agjëruar”.

Fillimi i agjërimit është: Vendosmëria (nijeti) për agjërim, natën (para sabahut).

Pjesa e jashtme e mohon formën e jashtme të agjërimit, kështu që është e domosdoshme t'i jepet kuptimi i ligjeve të agjërimit, i cili kuptim mohon pjesëzimin dhe vlerën.

Hadithi është gjithëpërfshirës dhe ka:

- Kuptimin e vlerës dhe
- kuptimin e shpërblimit.

Hadithi i Muhamedit a.s.: **“Është hequr nga umeti im gabimi dhe harresa.”**

Hadithi nuk e ka kuptimin e heqjes së gabimit dhe të harresës nga umeti në mënyrë absolute.

Kështu që është domosdoshmëri të përcaktohet “ligji”.

Ligji përfshin ligjin e kësaj bote dhe ligjin e botës tjetër.

“Të përgjithësuarit mbështetës”: përcaktohet në atë çka përfshijnë që të dy ligjet:

- Ligjin e kësaj bote.
- Ligjin e botës tjetër.

Hadithi: “Vërtetë veprat sipas qëllimit.”

Shikohet vetëm ana e jashtme, sepse paramendimi është se “Nuk ka vepër pa qëllim” e nuk është qëllimi mohimi i veprës, sepse mund të ndodhë vepër edhe pa qëllim; mirëpo qëllimi është se mohohen veprimet, e ato janë vlefshmëria dhe fuqizimi.

Arsyetim:

- Nijeti në abdes dhe gusël nuk është farz,
- nijeti në agjërim, në namaz dhe në haxh është farz.

- Nijeti në abdes dhe gusël nuk është farz nga shkaku se qëllimi i hadithit është se shpërblimi i veprës është në bazë të nijetit. Nijeti kërkohet për të arritur te shpërblimi.

- Nijeti në agjërim, në namaz dhe në haxh është farz, sepse ka dallim në mes të nijetit të mjeteve dhe nijetit në qëllim.

- në nijetin e mjeteve, si f.v. nijeti i abdesit dhe nijeti i gusulit nuk është farz.

- nijeti në qëllim (rezultatit final), si f.v. nijeti në namaz dhe agjërim është farz.

Hadithi: “Vërtetë veprat sipas qëllimit.” i jepet kuptimi i “përgjithësimi mbështetës”.

Shumësi mbështetës dhe shumësi

Nëse Ligjvënësi e ndërlihdh kërkesën me shumësin mbështetës dhe shumësin si p.sh.: **“Merr prej pasurisë së tyre sadaka”**, e ka shtuar fjalën “pasuri”, e cila është fjalë për shumësin e ngarkuar, e ajo është shumicë.

A do të thotë se duhet marrë tërë pasurinë e tyre apo një pjesë të tyre?

Këtu nuk ka përgjithësues dhe se mjafton që të merret sadakaja prej një lloji të pasurisë prej të gjitha llojeve të pasurisë.

Argument për këtë është përdorimi i kësaj forme vazhdimisht në Kur'an.

Në ajetin e lartpërmendur:

Merret prej pasurisë së çdo të ngarkuari, jo prej çdo pasurie, sepse këtë e ka treguar tradita dhe është arritur Ixhmai se në ajetin: **“Merr prej pasurisë së tyre”** qëllimi është prej të gjitha llojeve, e jo çdo personi.

Përgjithësuesi i ardhur për shkak të rastit të veçantë

(Qëllimi është te përgjithësimi i fjalës e jo te shkakut i veçantë)

Përgjithësuesi i ardhur për shkak të rastit të veçantë, kur pyetësi pyet ose ndodh ndonjë ngjarje e diçka e ngjashme, ai rast i veçantë konsiderohet i përgjithshëm duke shikuar fjalën nga aspekti i jashtëm, e nuk specifikohet vetëm në shkakun. Ky është qëllimi i tyre kur thonë: *“Qëllimi është te përgjithësuesi i fjalës, e jo te shkakut i veçantë”*.

Argument për përgjithësim është se: argumenti bazohet në fjalën e ligjvënës, e jo në pyetje.

Argument

Një njeri, e pyet Pejgamberin s.a.v.s.:

“Ne shkojmë në thellësi (largësi) të detit dhe me vete marrim pak ujë, e nëse atë ujë e shpenzojmë për abdes, mbesim pa ujë të pijshëm. A mund të marrim abdes me ujë të detit?”

Pejgamberi s.a.v.s. tha: **“Është i pastër uji i detit aq shumë), sa që lejohet edhe cofëtina e tij (detit)”**.

Thënia e Pejgamberit s.a.v.s.: **“I pastër uji i tij (detit)”** është gjithëpërfshirës, përfshin pyetësin, por edhe të tjerët, edhe pse ka ardhur nga shkakut i veçantë.

Shembulli i dytë:

Transmetohet në hadithë se:

“Shkon një njeri te Muhamedi a.s. e i thotë:

Jam shkatërruar, o i dërguar i Allahut.

Po si je shkatërruar? – e pyeti i dërguari a.s.

Kam kontaktuar me gruan në ditën e ramazanit (dhe e kam prishur atë ditë).

A ke rob të lirosh? – i thotë Muhamedi a.s.

Jo, nuk kam.

A ke mundësi t’i agjërosh dy muaj rresht?

Jo!

A ke mundësi t’i ushqesh gjashtëdhjetë të varfër?

Jo!”

Ky hadithë është gjithëpërfshirës, përfshin çdo agjërues që kontakton me gruan e tij gjatë agjërit.

Kefareti, edhe pse është posaçërisht për një njeri, është i plotfuqishëm për çdo njeri që kontakton me gruan e tij.

Ky hadithë është gjithëpërfshirës, përfshin edhe bashkëshorten, atëherë dënimi për bashkëshortët është që secili prej tyre:

– ose të lirojnë nga një rob,

– ose t’i ushqejnë nga 60 të varfër,

– ose t’i agjërojnë nga 60 ditë.

Përgjithësimi i ligjërimit vetëm me të shprehur apo edhe me të orientuar

Ligjërimi i drejtë (i shprehur) është ligjërimi, i cili bëhet me të shprehur në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. si f.v. “O ju njerëz”, “O ju që keni besuar”.

Ligji

Ligjërimi i drejtë është i përgjithshëm për ata që vijnë pas atyre, që kanë qenë prezent në moment kur është ligjëruar për ta dhe që do të jenë prezent në të ardhmen, nga shkakut se ligjërimi me të shprehur i drejtohet prezentëve në formë të prerë.

Ndërsa,

ata që vijnë pas tyre, edhe pse në atë moment nuk i përfshin ata, e kanë po të njëjtin tretman (dispozitë) në të ngarkuar, ngase ligjërimi i drejtë është absolut dhe nuk ka ndonjë argument që e ka bërë specifikimin.

Gjithëpërfshirja është prej vetë shprehjes.

Thënia e Pejgamberi s.a.v.s.:

“Jam dërguar për tërë njerëzimin në përgjithësi”.

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Ai është i Cili dërgoi te analfabetët të dërguar, nga mesi i tyre” deri te pjesa e ajetit: **“Dhe të tjerët prej tyre, që nuk kanë arritur ata (por kanë ardhur pas tyre)”**.

Llojet e përgjithësuesit dhe dallimi mes tyre

Llojet e përgjithësuesit janë:

- **Përgjithësuesi i paspecifikuar,**
- **përgjithësuesi specifikues, dhe**
- **përgjithësuesi asnjëherë.**

1. Përgjithësuesi i paspecifikuar.

Përgjithësuesi i paspecifikuar është përgjithësuesi i cili ka për qëllim përgjithësimin në formë të prerë, me fjalë tjera është përgjithësuesi i cili ka fakte se mohon mundësinë e specifikimit të tij.

Shembull:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Ka krijuar qiejt dhe tokën.”

“Allahu është i ditur për gjithçka.”

“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që nuk e ka furnizimin prej Allahut”.

Çdo ajet prej ajeteve të këtij lloji, të cilat vërtetojnë ligjin e Allahut, nuk ndryshon, kështu që nuk lejohet specifikimi i tyre.

Përgjithësuesi në mënyrë të prerë tregon përgjithësimin e tij dhe mbetet gjithëpërfshirës në të gjitha njësitet e tij në mënyrë permanente, pra është përgjithmonë përgjithësues dhe asnjëherë nuk specifikohet.

2. Përgjithësuesi specifikues i cili në mënyrë të prerë ka për qëllim specifikimin e tij.

Përgjithësuesi specifikues është përgjithësuesi i cili ka elemente që në mënyrë të prerë nuk e kërkon specifikimin e tij në disa njësi.

Shembull:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Njerëzit e kanë për obligim që për Allahun ta kryejnë haxhin në shtëpinë e Tij, për ata që kanë mundësi”.

Pjesa e ajetit: “Për ata që kanë mundësi” e bën përgjithësimin për ata që kanë mundësi, por çdo njeri që ka mundësi nuk e ka për obligim haxhin, por e ka obligim vetëm i moshërrituri dhe i mençuri, e nuk e kanë për obligim të çmendurit dhe fëmijët, nga shkak se mendja është ajo që nuk i fut brenda obligimit fëmijën dhe të çmendurit.

3. Përgjithësuesi asnjanes.

Përgjithësuesi asnjanes në mënyrë absolute ka argument se as nuk ka pengesë që të specifikohet dhe as nuk ka argument që të lejohet të specifikohet.

Përgjithësuesi asnjanes nuk mund të ketë faktor që mohon mundësinë e specifikimit, po as nuk ka faktor që mohon që të jetë i përgjithshëm gjithmonë.

Shumica e teksteve absolute nuk kanë fakte gjuhësore, as logjike e as tradicionale.

Shembull: Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Të shkurorëzuarat le të presin tri kohëra të pastrimit”.

Pjesa e ajetit “të shkurorëzuarat”, qartazi tregon për përgjithësimin absolut për çdo të shkurorëzuar, përderisa nuk e vërteton ndonjë argument për specifikim.

Dallimi në mes të përgjithësuesve

Dallimi në mes të llojeve të përgjithësuesve ekziston në perceptimin e faktorëve:

- Përgjithësuesi, i cili ka për qëllim përgjithësimin, posedon faktorin i cili tregon vetëm përgjithësimin e tij.

- Përgjithësuesi, i cili ka për qëllim specifikimin, posedon faktorin i cili tregon se ka për qëllim specifikimin e tij.

- Përgjithësuesi asnjans është ai, i cili është i zhveshur prej faktorëve, që tregon specifikimin ose përgjithësimin e përgjithmonshëm.

Dallimi në mes të përgjithësuesit specifikues dhe përgjithësuesit i cili ka për qëllim specifikimin

Dallimi në mes të përgjithësuesit specifikues dhe përgjithësuesit i cili ka për qëllim specifikimin, është se:

Përgjithësuesi specifikues është më i përgjithshëm se përgjithësuesi i cili ka për qëllim specifikimin.

E përgjithshmja specifikuese ka qëllim më të gjerë nga ajo çka nuk ka qëllim më pak.

Ajo çka ka për qëllim specifikimin është që ka për qëllim më pak specifikimin, e më shumë jo specifikimin. Ligjëruesi nëse ka për qëllim të parën, e tregon atë çka tregon përgjithësimin, e tek pastaj i nxjerr (përfshihet) prej atyre që i tregon fjala, pa marrë parasysh a është përgjithësues apo specifikues, e nuk është përgjithësues që ka për qëllim specifikimin. *Shembull:*

Janë ngritur njerëzit.

Nëse ka pasur për qëllim të tregojë p.sh. ngritjen e Zejdit, e jo të dikujt tjetër, ky është përgjithësues që ka për qëllim specifikimin.

Nëse ka për qëllim ngritjen e vet Zejdit, ky është përgjithësues specifikues.

Dallim tjetër në mes të përgjithësuesve

Përgjithësuesi i cili ka për qëllim specifikimin, ka nevojë për argumentimin kuptimor, i cili nuk lejon që të nënkuptohen që të gjithë, por që përkufizon dhe i dallon disa.

Përgjithësuesi specifikues ka nevojë për specifikimin me fjalë, në të shumtën e rasteve, ashtu siç është specifikimi i kushtit, përjashtimit dhe qëllimit.

Përmbajtja:

FJALA SPECIFIKE (EL-HAS).....	4
<i>Ligji i fjalës specifiku</i>	6
<i>Çka është e obliguar në mehr</i>	9
<i>Llojet e fjalës specifike, varësisht prej formës</i>	10
KAPITULLI I PARË	13
MUTLAK - PAPËRCAKTORI.....	15
<i>Nocioni i të papërcaktuarit</i>	16
<i>Ligji i papërcaktorit</i>	17
<i>Përcaktimi i papërcaktorit</i>	19
MUKAJED - PËRCAKTORI	21
NOCIONI I PËRCAKTORIT	22
<i>Ligji i përcaktorit</i>	23
<i>Të barturit e të papërcaktuarës në të përcaktuar</i>	26
<i>Forma e parë: Kur papërcaktori dhe përcaktori janë të bashkuar në ligj dhe në shkak</i>	30
<i>Forma e dytë: Kur ndryshojnë ligji dhe shkak</i>	32
<i>Forma e tretë: Kur ndryshojnë ligjet, ndërsa shkak është i njëjtë.</i>	34
<i>Forma e katërt: Kur ligji është i njëjtë, por shkaqet janë të ndryshme.</i> ..	35
KAPITULLI I DYTË	39
FJALA PËRGJITHËSUESE (EL-AMË).....	42
<i>Definicioni i fjalës përgjithësuese</i>	42
<i>Format e përgjithësuesit</i>	43
<i>Fjalët treguese të përgjithësuesit</i>	44
<i>Dallimi në mes të papërcaktuarës, të përcaktuarës, trajtës së shquar trajtës së pashquar dhe përgjithësuesit</i>	47
<i>Trajta e pashquar në kontekstin e mohimit, ndalimit apo kushtit</i>	51
<i>Tregueshmëria e përgjithësuesit</i>	54
<i>Argumentet nga Kurani, nga Ixhmai i sehabeve dhe argumenti logjik</i> .	54
<i>Llojet e përgjithësuesit</i>	56
SPECIFIKIMI I PËRGJITHËSUESIT.....	60
SPECIFIKIMI I PËRGJITHËSUESIT.....	62
<i>Specifikimi i Kur'anit me Kur'an</i>	64
<i>Specifikimi i përgjithësuesit me Sunet</i>	66
<i>Specifikimi i përgjithësuesit të formës së prerë me argument të pasigurt</i>	68
<i>Specifikimi i ajetit të Kur'anit me hadithin njëtransmetuesor</i>	69
<i>Specifikimi i suneteve mutevatir me hadithin njëtransmetuesor</i>	71

<i>Specifikimi i suneteve mutevatir me Kijasë</i>	<i>71</i>
<i>Kontradikta ndërmjet përgjithësuesit dhe specifikuesit</i>	<i>72</i>
<i>Specifikimi i pashkëputur (ndërfjalor)</i>	<i>74</i>
<i>Mënyrat e specifikimeve</i>	<i>79</i>
<i>Heshtja e Pejgamberit s.a.v.s. për të kundërtën e përgjithësuesit</i>	<i>80</i>
<i>Specifikuesi i pandërprerë</i>	<i>81</i>
<i>Specifikuesi i ngjitur</i>	<i>81</i>
<i>Specifikuesi i kushtit</i>	<i>81</i>
<i>Specifikuesi i atributit</i>	<i>82</i>
<i>Specifikuesi i qëllimit</i>	<i>82</i>
<i>Ligji i përgjithësuesit pasi që të specifikohet</i>	<i>84</i>
<i>Të vepruarit me përgjithësuesin para se të hulumtohet specifikimi i tij</i>	<i>85</i>
<i>Të veçuarit e njësishë nga përgjithësuesi me ligjin e tij, jo me ligjin</i>	
<i>specifikues</i>	<i>87</i>
<i>Specifikimi i përgjithësuesit me të kuptuar të kundërt</i>	<i>88</i>
<i>Të përgjithësuarit mbështetës apo të përgjithësuarit nga anulimi retorik</i>	
<i>.....</i>	<i>89</i>
<i>Fjala në kuptim të drejtë dhe përcaktimi i përgjithësuesit</i>	<i>90</i>
<i>Fjala e cila ka shumë përcaktime nga përgjithësuesi i anulimit retorik</i>	<i>91</i>
<i>Shumësi mbështetës dhe shumësi</i>	<i>94</i>
<i>Përgjithësuesi i ardhur për shkak të rastit të veçantë</i>	<i>95</i>
<i>Përgjithësimi i ligjërit vetëm me të shprehur apo edhe me të orientuar</i>	
<i>.....</i>	<i>97</i>
<i>Llojet e përgjithësuesit dhe dallimi mes tyre</i>	<i>98</i>
<i>Dallimi në mes të përgjithësuesve</i>	<i>100</i>

